



ANALIZA PËR PRAKTIKAT E PARLAMENTEVE NË RAPORT ME BASHKËSINË ME HENDIKEP

Western Balkans
Democracy Initiative

 Funded by
UK Government



Emri i publikimit:

Analiza për praktikat e parlamenteve në raport me zbatimin e bashkësisë me hendikep

Redaktorë:

Eva Jovanova, Ivana Arsovska Trajanoviq, Dejan Dimitrievski, Tome Gushev/
Instituti Parlamentar i Kuvendit të RMV dhe

Petar Trajkov / Fondacioni i Uestminster për demokraci

Autorë:

Elena Koçovska / Polio Plus – Lëvizja kundër hendikepit

Julijana Klimoska Andonov / Polio Plus – Lëvizja kundër hendikepit

Dizajn grafik:

Angela Kostovska / Fondacioni i Uestminster për demokraci


Shkup, 2020

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
PËRMLLEDHJE.....	6
HYRJA.....	9
METODOLOGJIA.....	8
KAPITULLI 1. DETYRIMET DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE.....	13
1.1 DOKUMENTET DHE MARRËVESHJET RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE NË SISTEMIN E KE-SË DHE BE-SË.....	14
1.2 KONVENTA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	15
KAPITULLI 2. ANALIZA E PRAKTIKAVE TË MIRA NË PARLAMENTET E BOTËS DHE TE NE.....	16
2.1 POLITIKA PËR PËRFSHIRJET TË PERSONAVE ME HENDIKEP DHE SIGURIMI I QASSHMËRISË.....	18
2.1.1 Politika/politikat për përfshirjen e personave me hendikep në jetën parlamentare.....	20
2.2 STRUKTURA EFIKASE PARLAMENTARE.....	24
2.2.1 Mbështete për deputetët për çështje në lidhje me Konventën.....	30
2.3. KOMUNIKIMI QË ËSHTË I QASSHËM DHE I KUPTUESHËM PËR TË GJITHË.....	32
2.4 AKTIVITETET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA.....	38
2.5 KRIJIMI I PARTNERITETEVE.....	45
2.5.1 Bashkëpunimi me organizatat e personave me hendikep.....	45
KAPITULLI 3 HAPAT TË CILAT DUHET TË NDËRMERREN.....	49
3.1 REKOMANDIMET E PARLAMENTIT DREJTË ZBATIMIT TË KONVENTËS.....	50
3.2 REKOMANDIMET PËR IP DREJTË ZBATIMIT TË KONVENTËS.....	50
BIBLIOGRAFIA.....	52



LISTA E SHUKURTESTAVE



- DG COMM** – Drejtorati i përgjithshëm për komunikime pranë Parlamentit Europian
- JCHR** – Komiteti i përbashkët për të drejtat e njeriut në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar i Britanisë të Madhe dhe Irlandës Veriore
- APPG** – Grupi parlamentar i të gjithë partive për çështjen e hendikepit në Mbretërinë e Bashkuar
- OQ** – Organizatat qytetare
- KEDNJ** – Konventa Europiane për të drejtat e njeriut
- PE** – Parlamenti Europian
- GJEDNJ** – Gjykata Europiane për të drejtat e njeriut
- BE** – Bashkimi Europian
- BESH** – Bashkimi Europian i të shurdhërve
- IZ** – Izrael
- GPNP** – Grupi parlamentar ndërpartiak
- Komiteti për KDPH** – Komiteti për të drejtat e personave me hendikep pranë Kombeve të bashkuara
- RMV** – Republika e Maqedonisë së Veriut
- PNDCP** – Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
- OECP** – Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim
- OPH** – Organizatat e personave me hendikep
- OKB** – Organizata e Kombeve të Bashkuara
- MB** – Mbretëria e Bashkuar e Britanisë të Madhe dhe Irlandës të Veriut
- OSBE** – Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë
- PETI** – Komiteti parlamentar për peticione
- IP** – Instituti parlamentar
- KPKE** – Kuvendi parlamentar i Këshillit të Europës
- KE** – Këshilli i Europës
- SLL** – Republika e Sllovenisë
- DUDNJ** – Deklarata universale për të drejtat e njeriut
- FRA** – Agjencia pranë BE për të drejtat themelore të njeriut
- KR** – Republika e Kroacisë
- ÇE** – Republika Çeke

Përmbledhje



Kjo analizë ka për qëllim që të jap një pasqyrim krahasues të praktikave të parlamenteve në disa vende në drejtim të kuptimit të gjendjes dhe praktikave të cilat ekzistojnë te ne dhe në botë për zbatimin e një pjese të dispozitave nga Konventa nga ana e parlamenteve. Pasqyra e gjendjes në gjashtë parlamentet është vijuar me përfundime dhe rekomandime të cilat janë të rëndësishme të cilat janë të rëndësishme për zbatimin efektiv të Konventës në Kuvendin e RMV dhe Institutin parlamentar.

Informatat në analizë theksojnë se Parlamenti Europian dhe Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar, kanë politika të bazuara në parimin e mosdiskriminimit dhe përfshirjes të bazuara në Konventë, duke përfshirë edhe masat për përshatjen e duhur. Mjaftë pozitiv është fakti që këto parlamente ndajnë edhe mjete buxhetore për përshatjen e duhur. Kur bëhet fjalë për qasshmërinë, në analizë ndahet edhe Parlamenti i Izraelit i cili ka siguruar para së gjithash qasshmëri funksionale dhe mundëson një ofertë të madhe të elementeve për përshatjen e duhur të personave me pamundësi të ndryshme, të cilat janë të precizuara në detaje në Ligjin për të drejta të barabarta të qytetarëve me hendikep i cili është lex specials.

Parlamentet në përgjithësi ndërmarrin masa për sigurimin e qasshmërisë, por pa patur qasje sistematike. Te shumica e parlamenteve, parimet e qasshmërisë nuk janë pjesë e dokumenteve strategjike dhe nuk kanë udhërrëfyes për sigurimin e përshatjes të duhur.

Informatat theksojnë se ka një përfaqësim të vogël të personave me hendikep si deputetë me hendikep. Ajo që ndahet si mekanizëm i mirë është sistemi i kuotave për deputetët me hendikep në dhomën e poshtme, si dhe sistemi i kuotave për praktikantët dhe stazhantët (stazhierët) me hendikep në shërbimet e parlamentit. Në pajtim me dispozitat e kornizës ligjore në Izrael, përmes sistemit të kuotave, Parlamenti është i detyruar që të përfshijë personat me hendikep në fushat dhe shërbimet e

ndryshme në Kuvend.

Grumbullimi i të dhënave si dhe evidentimi i të punësuarve me ndikim mungon si praktikë, me përjashtim të Parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar. Parlamenti pranë Mbretërisë të Bashkuar thekson se është i vogël numri i personave të cilët deklarojnë se kanë hendikep. Kjo në vete është indicje për dështimin e shteteve që të sigurojnë promovimin e çështjes të hendikepit nga aspekti i të drejtave të njeriut, si dhe promovimin dhe pranimin se gjendja a pamundësisë është pjesë e shumëllojshmërisë të njerëzve.

Për shkak se ende po përfaqësohet qasja mjekësore për çështjen e hendikepit, parlamentet përmes trupave të themeluara të punës insistojnë që të afrohen me modelin social për çështjen e hendikepit. Ajo që ndahet si praktikë e mirë është ajo që çdo komitet në PE ka përgatitur plan për atë se çfarë do të bëjë për çështjen e hendikepit në fushëveprimin e tij të punës. Trupat tjera të punës në parlamente punojnë në mënyrë stihike për këtë çështje. Vetëm në tre çështje ekzistojnë grupet joformale (Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar, në PE dhe në Kuvendin maqedonas) të cilët bashkojnë partitë politike që të punojnë në çështjen e pamundësisë në koordinim me OPH. Në atë drejtim çdo parlament nacional, e duke patur parasysh shtrirjen e Konventës, duhet të vendosë praktikën që çdo trup punues ka për detyrë që në çdo fushëveprim të punës të inkorporojnë çështjen e pamundësisë.

Parlamentet sigurojnë trajnime në lidhje me qasshmërinë dhe komunikimin me personat me hendikep. Trajnimet për këtë temë organizohen në mënyrë sistematike sidomos në parlamentin e Izraelit (detyrimi i përcaktuar me Ligj), në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar të Britanisë të Madhe dhe Irlandës të Veriut (MB) (politika dhe praktika të vendosura) si dhe në PE. Në këto parlamente realizohen trajnime për të gjithë ekipin dhe kanë udhërrëfyes të cilët janë të trajnuar për komunikim me personat me hendikep. Megjithatë edhe krahas këtyre fushave tematike nevojitet që të organizohen

edhe trajnime sistematike për vetë deputetët, si dhe për shërbimet juridike të cilat japin mbështetje për deputetët për tema dhe fusha të ndryshme të cilat i mbulon vetë Konventa.

Në aspekt të informatave të qasshme, Parlamentit i Mbretërisë të Bashkuar ka përgatitur strategjinë për komunikim. Në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar, PE, si dhe Parlamentin e Izraelit, Çekisë dhe Sllovenisë, praktikë e mirë është se kanë formë video dhe audio, si dhe pajisje që mund të ndihmojë personat me hendikep sensorik. Në shtete, gjuha e shenjave, nuk është inkorporuar në mënyrë sistematike, mirëpo edhe në PE edhe në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar, si dhe në Izrael, me kërkesë sigurohet përkthimi në gjuhën e shenjave. Në kuadër të Parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar, gjuha britanike e shenjave është mundësuar në seancën për pyetje parlamentare në Dhomën e poshtme. Kur bëhet fjalë për organizimin e ngjarjeve, praktika është e ndryshme. Parlamentet ndonjëherë qasen në organizimin e ngjarjeve dhe vizitave të rregullta dhe i ftojnë të gjithë, duke përfshirë edhe personat me hendikep. Krahas ngjarjeve të rregullta dhe/ose vizitave, parlamentet qasen edhe në organizimin e vizitave speciale dhe/ose ngjarjeve të cilat janë të parapara vetëm për personat në gjendjen e caktuar të hendikepit. Gjatë vizitave të rregullta, i rëndësishëm është koncepti i përshtatjes të duhur, që është organizuar në mënyrë solide në Parlamentin e Izraelit, Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar, Parlamentin European, atë Slloven dhe Çek.

Parlamentet theksojnë se një pjesë të aktiviteteve të tyre gjatë pandemisë, i kanë riorganizuar, sidomos vizitat në parlament, por të njëjtat nuk kanë ndikim të madh mbi personat me hendikep. Ndryshimet më të mëdha dhe riorganizimi është bërë nga Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar dhe PE. Parlamen-

ti i Mbretërisë të Bashkuar dhe PE theksojnë se është shumë e rëndësishme përfshirja dhe bashkëpunimi me personat me hendikep dhe organizatat e personave me hendikep. Është thelbësore që parlamentet të bashkëpunojnë me organizatat shumë-sektoriale dhe/ose me koalicionet e organizatave të personave me hendikep.

Përfundimet dhe rekomandimet që rrjedhin nga analiza e realizuar udhëzojnë në atë që është e domosdoshme që të ndërmerren aktivitete nga ana e Parlamentit maqedonas dhe IP, në të cilat çështja e pamundësisë do të përfshihet në të gjithë rrjedhat e tyre. Zbatimi i rekomandimeve në të njëjtën kohë do të kontribuojnë që parlamenti maqedonas të bëhet një shtëpi ligjvënëse me përfshirëse që do të përfaqësojë, avokojë, promovojë por edhe mbrojë të drejtat e të gjithë qytetarëve me dhe pa hendikep.



HYRJA



Në dekadat e fundit, gjithnjë e më shumë shqyrtohet roli i Parlamentit në përparimin e të drejtave të njeriut. Parlamenti ka rol të madh dhe thelbësorë jo vetëm në aspekt të miratimit të ligjeve, por edhe në zbatimin e mbikqyrjes dhe konformitetit dhe pajtueshmërisë të të njëjtave me detyrimet që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar Kuvendi dhe të cilat janë pjesë e legjislacionit nacional. Nga aspekt i të drejtave të njeriut, secili parlament vepron kryesisht si ligjvënës. Prandaj, gjithmonë ekziston rreziku që parlamenti kombëtar mund të shkel ndonjë të drejtë apo të lejojë, përmes ligjeve kombëtare, mbrojtje jo të duhur në lidhje me standardet ndërkombëtare, sidomos ata që rrjedhin nga Konventa për të drejtat e personave me hendikep (në tekstin e mëposhtëm Konventa). Parlamenti ndoshta edhe duhet të ketë rol proaktiv në promovimin dhe njohjen efektive si për të drejtat civile dhe politike, ashtu edhe për të drejtat ekonomike dhe sociale të qytetarëve me hendikep.


Me ratifikimin e Konventës, pjesëmarrja e personave me pamundësi tashmë një kohë të gjatë është pjesë e agjendës të punës të parlamenteve. Analiza a realizuar jep pasqyrën e praktikave të vendosura në gjashtë vendet dhe jep kornizën që do i ndihmojë parlamentit që të vlerësojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa si dhe përfshirjen e personave me pamundësi si pjesë e demokracisë përfaqësuese.

Analiza nuk ka për qëllim që të jap një përpunim gjithëpërfshirës teorik të çështjes të hendikepit, e as të tregojë në analizën e ekzemplarit përfaqësues, por të tregojë në mënyrë indikative gjendjen dhe praktikat e përhershme të cilat ekzistojnë te ne dhe në botë për zbatimin e një pjese të dispozitave të Konventës nga ana e parlamenteve, si dhe të shqyrtohen mjetet dhe hapat e mundshme të ardhshme për përfshirjen e kësaj çështjeje në punën e Kuvendit të RMV dhe IP si pjesë e Kuvendit të RMV (në tekstin e mëposhtëm IP).

Analiza është përgatitur me mbështetje nga Fondacioni i Uestminster për Demokraci, kurse në bashkëpunim me Institutin Parlamentar dhe Polio Plus. Kjo analizë është përgatitur si pjesë e angazhimeve të vazhdueshme të Uestminster, Institutit Parlamentar dhe Polio Plus për përparimin e të drejtave të qytetarëve me hendikep në pajtim me dispozitat nga Konventa. Edhe krahas fushëveprimit të përkufizuar ngushtë, kjo analizë mund të jetë një mjet i dobishëm edhe për publikun më të gjërë të interesuar për temën, duke përfshirë partitë politike, organizatat e shoqërisë civile (në tekstin e mëposhtëm: OQ), organizatat e personave me hendikep (në tekstin e mëposhtëm: OPH) dhe organizatat ndërkombëtare.



METODOLOGIJA



Analiza është përgatitur duke shfrytëzuar metodologjinë e kombinuar që konsiston në shqyrtimin e literaturës dhe dokumenteve si dhe analizën e përgjigjeve të pyetësorëve të fituara nga parlamentet e 6 vendeve, dhe atë: Kuvendi i RMV, Parlamenti Europian (në tekstin e mëposhtëm: PE), Parlamenti i Republikës Sllovene, Parlamenti i Republikës Çeke, Parlamenti i Izraelit, si dhe Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar të Britanisë të Madhe dhe Irlandës të Veriut. Duhet të theksohet se të gjithë këto vende e kanë ratifikuar Konventën, dhe kështu kanë ndërmarrë detyrime të cilat rrjedhin nga kjo marrëveshje ndërkombëtare.


Pyetësi është strukturuar në 5 kapituj me një grup të nënpyetjeve të cilat i referohen politikave të cilat i kanë vetë parlamentet, përfaqësimit të personave me hendikep në vetë parlamentet, sigurimin e qasshmërisë dhe pështatjes të duhur për të punësuarit me hendikep, qasshmërinë e komunikimeve dhe mënyrën e të qenit të hapur të parlamenteve ndaj bashkësisë me hendikep, si dhe bashkëpunimin e vendosur i vetë parlamenteve me aktorët e ndryshëm për këtë çështje, duke përfshirë edhe aktivitetet të cilat parlamentet i ndërmarrin gjatë kohës të pandmisë me kovid-19.

Kjo analizë jep një fotografi indikative për njohjen dhe të praktikuarit e Konventës nga ana e parlamenteve. Në të njëjtën kohë, analiza detekton edhe qasjen e vetë parlamenteve për këtë çështje, në pajtim me praktikat dhe vlerat në vendet e tyre, si dhe përkushtimet dhe shërbimet e tyre të cilat punojnë në avancimin e të drejtave të njerëzve me hendikep në pajtim me Konventën.

Në mënyrë shtesë, analiza jep pasqyrë për atë që parlamentet dhe shërbimet e tyre ndërmarrin për tejkalimin e pengesave me të cilat përballen personat me hendikep, si nga aspekti i qasjes, disponueshmërisë të informatave, ashtu edhe në aspekt të aktiviteteve të drejtëara drejtë përforcimit të kapaciteteve të shër-

bimeve në parlament, duke përfshirë personat me hendikep dhe tejkalimin e stereotipeve ndaj personave me hendikep. Në fund, analiza tregon në cilat fusha është e domosdoshme që të ndërmerren masat dhe veprimet e mëtutjeshme më qëllim të përfaqësimit më aktiv të bashkësisë me hendikep në parlamentin maqedonas, si dhe të qenit më të hapur të parlamentit dhe shërbimeve, që në të njëjtën kohë do të jetë model të cilin duhet të ndjekin institucionet tjera në vend.

Gjatë analizës të informatave të fituara, janë marrë parasysh edhe politikat ekzistuese dhe praktikat e vendeve. Literatura dhe të dhënat ekzistuese të cilat janë përpunuar, bazohen në dokumentet juridike, praktikën e Komitetit për të drejtat e personave me hendikep, resurset e deritanishme (hulumtime, analiza, udhërrëfytes) dhe literatura e ndryshme akademike (punimet vendore dhe të huaja akademike).



KAPITULLI 1.

Detyrimet dhe standardet ndërkombëtare

1.1 Dokumentet dhe marrëveshjet rajonale dhe ndërkombëtare në sistemin e KE-së dhe BE-së

Në nivel të Këshillit të Europës (në tekstin e mëposhtëm: KE) nuk ekziston një marrëveshje e veçantë që i referohet të drejtave të personave me hendikep. Trupat e ndryshme pranë KE-së kanë marrë përfundime apo rekomandime për zhvillimin e mëtutjeshëm të standardeve për çështjen e pamundësisë. Me ratifikimin e Konventës nga ana e Bashkimit Europian (në tekstin e mëposhtëm: BE) nga viti 2010, janë ndërmarrë disa veprime për të avancuar të drejtat e qytetarëve me hendikep.

Aktivitetet e BE-së në aspekt të zbatimit të Konventës

Në vitin 2006, Komiteti i ministrave ka lëshuar rekomandimin për "Planin e veprimit të Këshillit të Europës me qëllim të avancimit të të drejtave dhe pjesëmarrjen e tërësishme të personave me hendikep në shoqëri" (2006-2015).¹ Rekomandimi përfshin masat konkrete për qasshmërinë e procedurave dhe objekteve për votim, sigurimin e mbështetjes nga personi sipas përzgjedhjes personale, vendosjen e informatave në dispozicion të formave alternative dhe promovimin dhe konsultimin e OPH².

Komiteti i ministrave i KE-së ka miratuar rekomandimin për pjesëmarrje të personave me hendikep në jetën politike dhe publike.³ Me këtë është theksuar pozita e Konventës. Në rekomandim përsëriten aspektet për qasshmërinë dhe ndihmën nga personi sipas përzgjedhjes personale dhe theksohet përfshirja e personave me hendikep në miratimin e vendimeve dhe nevoja për "informata dhe statistikë të besueshme dhe të krahasueshme".

KE ka miratuar Strategjinë për të drejtat e personave me hendikep 2017-2023,⁴ me çrast janë identifikuar pesë fusha prioritare: barazia, mosdiskriminimi, ngritja e vetëdijes, qasshmëria dhe njohja e barabartë para ligjit. Strategjia thekson se personat me hendikep duhet të gëzojnë njohjen e barabartë para ligjit dhe se zëvendësisimi në marrjen e vendimeve duhet të ndryshohet me sistemin e miratimit të mbështetur të vendimeve.

Komisioni i Venedikut në Kodeksin e reviduar të praktikave të mira për çështjet zgjedhore⁵ tregon se "e drejta universale në votë është një parim themelor dhe personat me hendikep nuk duhet të diskriminohen sipas nenit 29 nga Konventa dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ". Deklarata e interpretuar e reviduar udhëzon në qasjen në procedura dhe objekte për votim, në informata në forma alternative, teknologji ndihmëse dhe ndihmë nga personi sipas përzgjedhjes personale.

Në nivel të BE-së është miratuar Strategjia europiane për çështjen e hendikepit (2010-2020). Në të njëjtën është theksuar përpjekja dhe qëllimi që të arrihet "pjesëmarrje e tërësishme e personave me hendikep përmes: mundësitë që të gëzojnë të gjithë përfitimet nga shtetësia e BE-së dhe largimit të pengesave administrative dhe qëndrimet për pjesëmarrje të tërësishme dhe të barabartë".⁶

Në vitin 2016 në nivel të BE-së është miratuar Direktiva për qasje në ueb-faqet dhe aplikacionet mobile të organeve të sektorit publik. Në të njëjtën janë vendosur kushtet për qasje në ueb-faqet dhe aplikacionet mobile të organeve nga sektori publik me qëllim që të jenë më të qasshme për përdoruesit në vendet anëtare të BE-së.⁷

¹Shihni: Plani i veprimit i Këshillit të Europës, viti 2006, I disponueshëm në: <<http://www.coe.int/en/web/disability/action-plan-2006-2015>>.

²Shihni: Këshilli i Europës, Rekomandimi Rec(2006)5 i Komitetit të ministrave për Planin e veprimit 2006-2015". I disponueshëm në: <https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805af657>.

³Shihni: Rekomandimi CM/Rec(2011)14 i Komitetit të ministrave. I disponueshëm në: <https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cbe4e>.

⁴Shihni: Strategjia për të drejtat e personave me hendikep 2017 - 2023, Këshilli i Europës. E disponueshme në: <<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806fe7d4>>

⁵Shihni: Komisioni i Venedikut, Deklarata e interpretuar e reviduar për Kodeksin e praktikave të mira për çështjet zgjedhore për pjesëmarrje të personave me hendikep në zgjedhje, 2011. E disponueshme në: <<http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD%282011%29045.aspx>>

⁷Shihni: Strategjia europiane për hendikep 2010-2020. E disponueshme në: <<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0636:FIN:EN:PDF>>

⁸Shihni: Direktiva për qasje në ueb-faqet dhe aplikacionet mobile të organeve të sektorit publik. E disponueshme në: <<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32016L2102>>

1.2 Konventa për të drejtat e personave me hendikep


Një numër i madh i konventanve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Deklaratën universale për të drejtat e njeriut (në tekstin e mëposhtëm: DUDNJ), si dhe Konventa Europiane për të drejtat e njeriut (në tekstin e mëposhtëm: KEDNJ) nuk përkufizojnë qasjen as realizimin e të drejtave të qytetarëve me hendikep. Kjo është edhe një nga arsytet e miratimit të Konventës, si *lex specialis*, që në mënyrë horizontale përmes marrëveshjeve dhe konventave të vendosura, do të blujë të drejtat në aspekt të interesave të bashkësisë me hendikep.

Konventa paraqet marrëveshje me të cilën promovohen të drejtat e njeriut të personave me hendikep. Konventa thekson nevojën për zbatimin e paradigmes në lidhje me mënyrën në të cilën përkufizohet pamundësia dhe vendos theksin në barazinë dhe pjesëmarrjen e tërësishme të qytetarëve me hendikep në shoqëri si e drejta për jetë të pavarur.

Në Konventë duhet të shihet si një marrëveshje e zhvilluar progresive për të drejtat e njeriut që është e përkushtuar për realizimin thelbosor të barazisë inkluzive (përfshirëse).⁸

Me qëllim që të sigurohet kapitalizimi i potencialit që ofron vetë Konventa, e rëndësishme thelbësore është që shtetet dhe të gjithë aktorët e tyre shoqërorë në pushtetin ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësorë të vendosin kornizën për zbatimin progresiv të Konventës, në nivel kombëtar dhe lokal, si në lidhje me shpërndarjen e resurseve, ashtu edhe përmes qasjes programore të qytetarëve, të drejtave politike dhe socio-ekonomike dhe kulturore të bashkësisë me hendikep.

Duke patur parasysh rëndësinë dhe gjithëpërfshirjen e Konventës, është e dobishme që të theksohen parimet që çdo aktor shoqëror ka për detyrë që të zbatojë, pa dallim të asaj se çfarë lloji veprimi, masa apo në cilin nivel veprohet. Këto parime janë edhe të drejtat të cilat kanë zbatim horizontal dhe janë detyrim për realizim të drejtëpërdrejtë dhe nuk janë objekt i realizimit progresiv.



⁸Koment i përgjithshëm 16 (2005) për të drejta të barabarta të burrave dhe grave për të gëzuar të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 3 nga ICESCR), i miratuar në seancën e tretë dhe të katërt të Komitetit, viti 2005, UN Doc. E/C.12/2005/4



KAPITULLI 2.

Analiza e praktikave të mira në parlamentet e botës dhe te ne

Parlamentet kanë përgjegjësi të veçantë që të jenë shembull në shoqëri dhe të trasojnë rrugën drejtë krijimit të një mjedisi përfshirës për bashkësinë me hendikep.

Në vitet e kaluara janë ngritur disa aktivitete nga ana e parlamentit për promovimin e Konventës. Janë miratuar rezoluta në fusha të ndryshme përmes të cilave parlamentet dërgojnë porosi deri te aktorët shoqëror për domosdoshmërinë për një aktivizim më të madh të tyre që të mundën qytetarët me hendikep në mënyrë efektive të gëzojnë të drejtat e njeriut. Në të njëjtën, përmes aktiviteteve të tyre dërgojnë thirrjen që të pranohen dhe inkorporohen parimet nga Konventa në politikat strategjike të secilit shtet.

Në vitin 2017 KPKE ka miratuar Rezolutën 2155 për “të drejtat politike të personave me hendikep”.⁹ Rezoluta përpunon sfidat dhe praktikat e mira në vendet anëtare të KE-së dhe paraqet thirrjen e ripërtirë të KPKE në vend të mekanizmave për zëvendësim në miratimin e vendimeve të zbatohen mekanizma për miratimin e mbështetur të vendimeve.¹⁰

Në vitin 2016 nga ana e PE-së është miratuar Rezoluta për përdorimin e interpretimit në gjuhën e shenjave me të cilën “theksohet se shërbimet publike dhe qeveritare, duke përfshirë edhe përmbajtjen e tyre onlajn (elektronike), duhet të jenë të qasshme përmes ndërmjetësuesve aty për aty, siç janë interpretuesit në gjuhën e shenjave në vend, por, gjithashtu, edhe përmes shërbimeve alternative të bazuara në ueb dhe shërbimeve në distancë, ku një gjë e tillë është përkatëse...”.¹¹

Në vitin 2013, kryetarët e pesë grupeve kryesore politike të PE-së kanë miratuar deklaratën në të cilën propozojnë gjashtë iniciativa për mbështetje të personave me hendikep.¹²

Në dhjetor të vitit 2013, PE ka miratuar rezolutën për gratë me hendikep në të cilën tregohet pozita jo e favorshme e grave me hendikep. PE ka kërkuar miratimin e strategjive, iniciativave ligjvënëse dhe politikave që të garantohet mosdiskriminimi dhe mundësitë e barabarta të grave me hendikep.¹³

Në rezolutën e tij nga viti 2017 “Qasja e integruar ndaj politikës të sportit: qeverisja e mirë, qasja dhe integriteti”¹⁴, PE thekson se personat me hendikep duhet të kenë qasje të barabartë për të gjithë objektet sportive dhe ka kërkuar nga vendet që të paraqesin programe sportive për personat me hendikep në shkolla dhe universitete.

Në vitin 2003 me iniciativë të GPNP për të drejtat e personave me hendikep, Kuvendi maqedonas ka miratuar “Deklaratën për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave me nevoja të veçanta”. Deklarata kërkon ngritjen e vetëdijes publike, thekson masat që duhet të ndërmerren për të siguruar kushtet për mjedisin e disponueshëm fizik dhe qasje në komunikime dhe informata, mbrojtje të disponueshme shëndetësore dhe sociale, avancimin e procesit të arsimit, punësimit etj.¹⁵

⁹ E disponueshme në: <http://website-pace.net/documents/19879/3143407/20170130-Droitshandicapes-EN.pdf/e30d56a9-e78c-4691-b30b-1f1e-1da0d1d7>. [Është qasur në: 18 shtator të vitit 2020].

¹⁰ Shihni: Rezoluta 2039(2015) për “Barazi dhe përfshirje të personave me aftësi të kufizuara”, të miratuar nga KPKE në 30 janar të vitit 2015 (§5): <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-EN.asp?FileID=21339&lang=EN>.

¹¹ Rezoluta e Parlamentit Europian, 23 nëntor i vitit 2016 (2016/2952[RSP]). E disponueshme në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P8-TA-2016-0442+0+DOC+XML+V0//EN>.

¹² Shihni: Deklarata, takimi i krytarëve të partive politike të Parlamentit Europian me Forumin Europian për aftësi të kufizuara, Bruksel, 5 qershor i vitit 2013. E disponueshme në: < https://www.socialistsanddemocrats.eu/sites/default/files/swoboda_disabilities_declaration_en_130606.pdf >

¹³ Rezoluta e Parlamentit Europian për gratë me hendikep, Dhjetor 2013, 2013/2065(INI). E disponueshme në: < <https://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-%2F%2FEP%2F%2FTEXT%2FTA%2BP7-TA-2013-0579%2B0%2BDOC%2BXML%2BV0%2F%2FEN&language=EN> >

¹⁴ Rezoluta e Parlamentit Europian nga 2 Shkurti i vitit 2017 për qasje të integruar ndaj politikës sportive: qeverisja e mirë, qasja dhe integriteti (2016/2143 (INI)). E disponueshme në: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2017-0012_EN.html?redirect

¹⁵ Shihni: Deklarata për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave me nevoja të veçanta, “Gazeta zyrtare e RM-së” numër 50, 28 korrik i vitit 2003. E disponueshme në: <<http://www.slv.esnik.com.mk/Issues/94E66D528301B3469BD4ED2C440917ED.pdf> >

Në vitin 2019 me iniciativë të GPNP për të drejtat e personave me hendikep, Kuvendi ka miratuar “Deklaratën për pjesëmarrje politike të qytetarëve me aftësi të kufizuara”. Me Deklaratë, Parlamenti maqedonas kërkon afirmimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të qytetarëve me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe pjesëmarrjes të grave me aftësi të kufizuara në proceset politike dhe publike; i thirr partitë politike që të njohin të drejtat qytetare dhe politike të qytetarëve me aftësi të kufizuara dhe të sigurojnë përfshirjen e tyre, e nxit mbështetjen institucionale të qytetarëve me aftësi të kufizuara për zhvillimin e karrierës të tyre politike dhe sigurimin e mundësive të barabarta për arsimin qytetar dhe trajnimin e mbindërtimit politik të qytetarëve me aftësi të kufizuara;

2.1 Politika për përfshirje të personave me hendikep dhe sigurimi i qasshmërisë

Parimi dhe e drejta e qasjes, të cilat kanë karakter hibrid, duke përfshirë edhe përshtatjen e duhur si institut juridik, paraqet parakusht për realizimin e të drejtave të bashkësisë me hendikep.

PE dhe Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar dhe Izraelit kanë përgjigje pozitive për politikën e tyre nga aspekti i qasjes, por me fushëveprim të ndryshëm (Shihni: Tabelën P1).

PE thekson se politikën e tyre janë bazuar në parimet e mosdiskriminimit dhe përfshirjes, duke përfshirë mundësinë për të siguruar përshtatjen përkatëse.

Komiteti për rekomandimet e BE-së¹⁷ thekson se: PE ka rritur buxhetin e tij për një të tretën të destinuar për “Masat specifike për mbështetjen e personave me hendikep” në periudhë prej dy vitesh (nga 655 mijë euro në vitin 2017 në 876 mijë euro në vitin 2019). Mjetet buxhetore janë destinuar për personelin me hendikep, kurse lidhen me rekrutimin dhe punësimin e personave me hendikep në shërbimet e PE-së, shpenzimet për përshtatjen e duhur, mjetet e destinuar për praktikantë me hendikep, si dhe mjete për vizitorët me hendikep në PE.

Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar thekson se nuk kanë politikë, por kanë udhëzim për sigurimin e qasjes që i referohet si të punësuarve, ashtu edhe vizitorëve të jashtëm dhe pjesëmarrësve në programet që ofron vetë parlamenti.

Në këto dy shtete janë parashikuar mjete buxhetore të destinuar për mbështetje të projekteve, programeve për personat me hendikep (Shihni: Tabelën P 1.1). Për dallim nga PE ku ekziston procesi me identifikimin e mëparshëm të nevojave të personave me hendikep, në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar ekziston rrjeti më i gjërë i departamenteve të cilat kanë mjete buxhetore për të siguruar përfshirjen në seclin shërbim parlamentar. Në Dhomën e Lordëve, gjithashtu, janë siguruar edhe mjete për ngritjen e vetëdijes publike përmes punës në terren.

Nga materialet dhe videoja që ka përmendur Parlamentin e Izraelit, mund të shihet se është siguruar qasje e tërësishme funksionale me mundësi për përshtatje përkatëse për qytetarët me hendikep.¹⁸

Rregullativa ekzistuese ligjore në Izrael, në detaje e përpunon të drejtën për qasje si dhe përshtatjet të cilat duhet të sigurohen nga të gjithë institucionet duke përfshirë edhe parlamentin dhe gjykatatat.¹⁹ Parlamenti krahas qasjes të siguruar që është tërësisht funksionale ka përgatitur edhe udhërrëfyesin për përshtatjen përkatëse, si dhe procedurat e përgatitura për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte nga ana e qytetarëve me dhe pa hendikep.

¹⁷Shihni: Raporti i Parlamentit Europian me kërkesë të PETI për zbatimin e KDPH nga ana e PE për vitin 2018. I disponueshëm në: < [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/608830/IPOL_BRI\(2018\)608830_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/608830/IPOL_BRI(2018)608830_EN.pdf) >

¹⁸Shihni: Deklarata për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave me nevoja të veçanta, “Gazeta zyrtare e RM-së” numër 50, 28 korrik i vitit 2003. E disponueshme në: < <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/94E66D528301B3469BD4ED2C440917ED.pdf> >

¹⁹Shihni: Deklarata për pjesëmarrjen politike të qytetarëve me aftësi të kufizuara “Gazeta zyrtare e RMV” numër 267, 24 dhjetor i vitit 2019. E disponueshme në: < <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/032dcec806e2435b90de68be6195e4de.pdf> >

¹⁹Shihni: Raporti i Parlamentit Europian me kërkesë të PETI për zbatimin e KDPH nga ana e PE për vitin 2018. I disponueshëm në: < [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/608830/IPOL_BRI\(2018\)608830_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/608830/IPOL_BRI(2018)608830_EN.pdf) >

P1. A ka parlamenti juaj politika për qasshmëri? Nëse po, cilat janë të përfshira me politikën për qasshmëri (për shembull, deputetët, të punësuarit në shërbime të parlamentit, vizitorët e parlamentit, pjesëmarrësit në programet të cilat i ofron parlamenti dhe të ngjajshme?)

MQ	Jo
BE	Politika e Parlamentit European bazohet në parimet e mosdiskriminimit dhe përfshirjes, në pajtim me Konventën e OKB për të drejtat e personave me hendikep. Politika është e zbatueshme për të gjithë. Atje ku deputetë dhe të punësuarit me hendikep përballen me pengesa gjatë kryerjes të detyrave të tyre, ndërmerren masa për përshtatjen përkatëse me qëllim që të mundësohet largimi apo tejkalimi i këtyre pengesave. Parlamenti, gjithashtu, në mënyrë aktive përpiqet që të rrisë vetëdijen për kontributin e personave me hendikep dhe përparësitë e qasjes pozitive, me qëllim që të shmangen stereotipet dhe perceptimet negative.
IZ	Në pajtim me Ligjin për të drejtat e barabarta të qytetarëve me hendikep, çdo institucion duhet të ketë politika për të siguruar qasshmërinë dhe përshtatjen e duhur si në aspekt të qasshmërisë fizike ashtu edhe në aspekt të shërbimeve dhe komunikimit. Në vitin 2019, është përgatitur broshura për procedurat për qasshmëri në Kneset, në koordinim me departamentet e ndryshme të Kneset. Broshura është shpërndarë deri te të gjithë të punësuarit me qëllim të avancimit të mëtutjeshëm të qasshmërisë në organizatë dhe zbatimin e ligjeve dhe rregullativave të vlefshme.
ÇE	Jo, nuk ka politika të qasshmërisë në parlamentin tonë.
MB	Po, ka udhëzim për qasshmëri në të cilin janë përfshirë të gjithë që punojnë apo vizitojnë Parlamentin. Deputetët, grupet shkollore të cilët vizitojnë shërbimin parlamentar për arsim etj. Të gjithë vizitorët dhe pjesëmarrësit në programet që ofron parlamenti janë të përfshira me këtë udhëzim.
SLL	Shihni P 4.1

P1.1. A ka parlamenti fond të destinuar për mbështetje të projekteve, programeve dhe aktiviteteve të cilat janë drejtuar kah personat me hendikep? Nëse po, cilat janë kriteret për qasje në këtë fond?

MQ	Jo
BE	Ekzistojnë një numër i madh i instrumenteve financiare për mbështetje të personave me hendikep. Ekziston proces formal për të njohur hendikepin që duhet të përfundojë që të kualifikohet për këto instrumente.
IZ	Po. Politika e parlamentit është rregulluar në pajtim me Ligjin për të drejta të barabarta të qytetarëve me hendikep, ku në detaje janë përshkruar standardet dhe detyrimet e institucioneve publike dhe private në aspekt të sigurimit të qasshmërisë të personave me hendikep. Parlamenti, në mënyrë shtesë ka përgatitur udhërrëfyesin për përshtatjen përkatëse me procedurat për realizimin e tij.
ÇE	Zyra e Dhomës të poshtme e deputetëve nuk ka program apo projekt të drejtuar për mbështetje të personave me hendikep.
MB	Ekziston ekip për shumëllojshmëri dhe përfshirje që udhëheq këtë agjendë në çdo departament parlamentar. Ekipi i tillë është Dhoma e lordëve. Kemi udhëheqës me aftësim përkatës të vendit të punës, i cili udhëheq me fondin, me çrast u mundësohet deputetëve, që personeli i tyre dhe personeli i kuvendit me hendikep të marrin aftësim përkatës të vendit të punës, që të mundën në tërësi të shfrytëzojnë potencialin e tyre. Kemi komitetin ParliAble. Ky është rrjeti për mbështetje të personelit me hendikep në Parlament dhe punon në ngritjen e vetëdijes publike dhe mban ngjarje me buxhet më të vogël. Kemi ekip për aktivitete në terren i cili kontakton me grupe të ndryshme, duke përfshirë edhe personat me hendikep.
SLL	Nuk ka informata

Nëse shihen përgjigjet edhe të parlamenteve tjera, do të shihet se të njëjtat janë të vetëdijshme për parimin e qasshmërisë. Edhe krahas asaj që nuk theksojnë nëse kanë apo jo politika konkrete për këtë çështje, mund të shihet se të gjithë përdorin elemente të ndryshme që t'u mundësojnë qytetarëve me hendikep qasshmëri më të madhe.

Qasshmëria si pjesë e parimeve të politikës është theksuar nga tre parlamente. Ajo që është mjaftë pozitive te Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar dhe PE është ajo që kanë siguruar mjete financiare për përshtatjen përkatëse për të punësuarit me hendikep, personat që vizitojnë apo deputetët me hendikep. Edhe krahas asaj që nuk ka informatë konkrete për politikën në Parlament në Izrael, video-materiali dhe udhërrëfyesi tregon se parlamenti ka investuar shumë në sigurimin e qasshmërisë të plotë për të gjithë qytetarët me pamundësi.

Parlamenti i Izraelit krahas sigurimit të qasshmërisë funksionale, në mënyrë shtesë siguron një grup më të gjërë të shërimeve për përshtatjen përkatëse, që është shembull pozitiv për atë se si një institucion kujdeset për sigurimin e të drejtës të qasshmërisë në çdo nivel. Është e rëndësishme ajo që në këto parlamente kihet kujdes për zbatimin e institutit për përshtatjen përkatëse, me çrast deputetët dhe të punësuarit me hendikep të cilët krahas qasjes funksionale përballen me pengesa gjatë kryerjes të detyrimeve të tyre, nga ana e parlamentit ndërmerren masa për përshtatjen përkatëse. Në aspekt të praktikave në nivel të Izraelit duhet të theksohen detyrimet të cilat i ka shteti përmes miratimit të lex specials – Ligit për të drejtat të barabarta të qytetarëve me hendikep në pajtim me Konventën.

Parlamentet në përgjithësi ndërmarrin masa për sigurimin e qasshmërisë, por pa patur qasje sistematike. Për një pjesë të madhe të parlamenteve, parimet për privatësi nuk janë pjesë e dokumenteve strategjike dhe nuk kanë udhërrëfyes për të siguruar përshtatjen përkatëse.

2.1.1 Politika/politikat për përfshirjen e personave me hendikep në jetën parlamentare

E rëndësishme thelbësore për parlamentet është pjesëmarrja dhe përfshirja e personave me hendikep, qoftë kur bëhet fjalë për deputetët apo si pjesë e shërbimeve të vetë parlamentit. Ky është një nga parimet udhëheqëse të Konventës, i cili është pasqyruar në nenin 29 dhe si i tillë i referohet si pjesëmarrjes politike, ashtu edhe përfshirjes të personave me hendikep në shërbimet e parlamentit. Koncepti i përfshirjes dhe angazhimit të personave me hendikep është i lidhur ngushtë me normat dhe standardet, si dhe me besimet të cilat ekzistojnë në shtet. Në këtë proces i rëndësishëm të madhe është edhe detyrimi për grumbullimin e të dhënave dhe evidencës për përfaqësimin dhe përfshirjen e personave me hendikep (neni 31). Mospasja e statistikës, por edhe vetë rezistenca nga ana e personave që të identifikohen si persona me hendikep tregon se vlerat ekzistuese të cilat promovohen në vende, nuk janë në frymën e Konventës. Komisioni për barazi dhe të drejta të njeriut në Britaninë e Madhe thekson se qëndrimet janë çështje themelore në bashkësi sepse "dëshmitë sygjerojnë se qëndrimet negative të publikut kanë ndikim të madh mbi kandidatët e mundshëm politik me hendikep".²⁰

²⁰Shihni më shumë: Raport "Zbutja e rrugës për personat me hendikep drejtë politikës 2015, Komisioni për barazi dhe të drejtat e njeriut – Britani e Madhe, 2015, I disponueshëm: < <https://www.equalityhumanrights.com/en/file/4661/download?token=PII5W6zL>>

Në pyejtjet, nëse parlamentet kanë deputet/e me hendikep (Shihni:Tabelën P1.2) dhe nëse kanë punësuar persona me hendikep në shërbime ((Shihni: Tabela P1.2), përgjigjet nga parlamentet janë të ndryshme, dhe të njëjtat shpiejnë në indicjen se shtetet, por edhe vetë institucionet nuk kanë kornizë të duhur për mbajtjen e statistikës për këtë çështje.

Parlamentet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Sllovenisë tregojnë se nuk kanë informatë për këtë çështje, si dhe se nuk ka persona të punësuar me hendikep, as nuk kanë deputet të zgjedhur me hendikep. Parlamentet në Mbretërinë e Bashkuar dhe Çeki, si dhe PE theksojnë se krahas deputetëve me hendikep, kanë të punësuar me hendikep në shërbimet parlamentare.

Në atë drejtim janë edhe praktikat në Izrael. Nga Kneseti theksojnë se krahas dy deputetëve në përbërjen aktuale, kanë edhe të punësuar me hendikep. Por, detyrimet e tyre për punësim dhe përfshirje të personave me hendikepin rrjedhin nga Ligji për të drejta të barabarta të qytetarëve me hendikep, ku secili institucion²¹ duhet të sigurojë përfaqësim të personave me hendikep, si dhe të ndërmarrë masa për të siguruar përshtatjen përkatëse. Në pajtim me Ligjin, punëdhënësi mund të jap përparësi punësimit dhe avancimit të personave me hendikep të cilët janë të kualifikuar për punën apo pozicionin përkatës dhe të cilët posedojnë kualifikime të ngjajshme me ato të kandidatëve tjerë për vendin e punës. Në bazë të përgjigjeve të dhëna, në Kuvendin e Izraelit janë përfshirë 33 persona me hendikep në fushat e ndryshme, si në administratën e Kuvendit, ashtue dhe në fushën teknike dhe të turizimit.

P1.2. A ka Parlamenti juaj deputet me hendikep?

MQ	Jo
BE	Po, disa.
IZ	Në përbërjen e tashme të deputetëve ka dy deputet të cilët janë me hendikep.
ÇE	Po
MB	Disa, në të dy dhomat e parlamentit (në Dhomën e poshtme dhe në Dhomën e lartë)
SLL	Nuk ka informata

P1.3. A është punësuar ndonjë person me hendikep në shërbimin e kuvendit?

MQ	Jo
BE	Po
IZ	Kneseti punëson persona me hendikep shumë vite. Ky ishte institucioni i parë publik i cili drejtëpërdrejtë angazhonte persona me hendikep, duke filluar nga viti 2008. Në vitin 2016, Kneseti ka lëshuar tenderin e parë që është përshtatur në mënyrë speciale për personat me hendikep. Për momentin, Kneseti ka 33 të punësuar të përhershëm me hendikep (fizik dhe kognitiv) të cilët punojnë në fushat e ndryshme, duke përfshirë edhe punën postare, mbështetjen teknike, turizmin, punën administrative dhe përfshirjen. Gjithashtu, të punësuarve në Kneset dhe anëtarëve me aftësi të kufizuara (të përkohshme apo të përhershme) të Knesetit u është siguruar përshtatja përkatëse.

²¹Shihmi më shumë: Ligji për të drejta të barabarta për personat me hendikep, Izrael, I disponueshëm në: <https://dredf.org/legal-advocacy/international-disability-rights/international-laws/israel-equal-rights-for-people-with-disabilities-law/>

ÇE	Në Dhomën e poshtme të deputetëve punojnë 6 persona me hendikep.
MB	Po shumë, por e dijmë se shkalla e deklarimit është e ulët. 8% e të punësuarve kanë hendikep si përqindje të atyre që kanë plotësuar pyetësonin.
SLL	Nuk ka informata

P1.4. Në këtë mënyrë, Parlamenti i inkurajon burrat dhe gratë me hendikep që të aplikojnë dhe të marrin pjesë në programe të cilat i realizon Parlamenti (programe civile, udhëheqëse, për përvojë praktike apo programe tjera publike për trajnim)?

MQ	Nuk ka informata
BE	Nuk ka informata
IZ	Në pajtim me Ligjin për të drejta të barabarta të qytetarëve me hendikep, çdo institucion duhet të mbajë llogari për përfaqësueshmërinë dhe përfaqësimin e qytetarëve me hendikep.
ÇE	Nuk kemi strategji të tillë.
MB	Disa skema të punës praktike dhe mësimi dhe kuota për personelin me hendikep. Ekzistojnë 3 vende me kuota për praktikantë me hendikep. Të gjithë kandidatëve me hendikep të cilët përmbushin kriteret minimale për ndonjë pozitë u garantohet intervistë. Që të thirren në intervistë, nga kandidati kërkohet që të përmbush të gjithë kriteret thelbësore për vendin e punës dhe të realizojnë 2 apo më shumë pike për secilin kriter të ripërtirë.
SLL	Nuk ka informata.

Mënyra në të cilën sigurohet përfaqësimi dhe përfshirja e personave me hendikep në institucione publike në shtete të ndryshme është i ndryshëm. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar thekson se ka sistem të kuotave për përfshirjen e personave me hendikep në parlament si deputet, por edhe sistem të kuotave në mekanizmin e punës praktike (Shihni: Tabela P1.4) Parlamenti i Izraelit thirret në Ligjin për të drejta të barabarta të qytetarëve me hendikep²² ku është theksuar se “secili institucion me më shumë se 25 të punësuar duhet të sigurojë përfaqësimin dhe përfaqësueshmërinë e personave me hendikep, ndërsa institucionet dhe firmat me më shumë se 100 të punësuar, kanë sistem të kuotave prej 3%”. Për dallim prej këtyre dy vendeve, PE, si dhe parlamenti çek, slloven dhe maqedonas nuk theksojnë se në cilën mënyrë dhe nëse ka masë me të cilën inkurajohen edhe burrat edhe gratë me hendikep që të jenë të përfaqësuar dhe të përfshirë në punën e parlamentit.

²²Види повеќе: Закон за еднакви права на граѓаните со хендикеп, Поглавје Д, Соодветна застапеност на лицата со хендикеп, Достапно на: <<https://private.disabilityin.org/global/israel/>>

Në raportin e Komisionit për barazi dhe të drejta të njeriut në Britaninë e Madhe në vitin 2014 theksohet se në vitin 2010, Qeveria e Britanisë të Madhe ka dhënë propozim që Dhoma e poshtme e Parlamentit të përfshijë të paktën 65 deputetë me hendikep. Në raportin e njëjtë, Komisioni ka konstatuar se numri i saktë i deputetëve me hendikep nuk është i njohur sepse rekomandimi që Dhoma e poshtme të mbajë evidencë dhe të dhëna, ende nuk është zbatuar. As Parlamenti i Uellsit, as Parlamenti i Skocisë nuk mbajnë evidencë. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se nuk është miratuar dispozita në Ligjin për barazinë e partive politike që të publikojnë të dhëna për dallueshmërinë e kandidatëve të tyre.²³

Në të njëjtën kohë, Komisioni për barazi dhe të drejtat e njeriut, thekson se në periudhën ndërmjet viteve 2010 dhe 2014, ka zhvillim domethënës gjatë përfshirjes të deputetëve me baza të ndryshme dhe atë: deputetët të cilët nuk i takojnë racës të bardhë përbëjnë më shumë se 6% të Dhomës të Poshtme, që paraqet rritje për 56% në raport me vitin 2010; 29 nga deputetët janë gra – për dallim nga 22% në vitin 2010. Në Dhomën e lordëve, 11% nga deputetët e emëruar nga viti 2000 kanë deklaruar se kanë ndonjë gjendje të hendikepit. Numri i tyre është zvogëluar në vitin 2015 me çrast katër deputetë me hendikep ose janë pensionuar ose kanë braktisur vendet e tyre, duke lënë vetëm dy që janë deklaruar se janë me hendikep.²⁴

Në vitin 2014, qeveria scoceze ka mbështetur pilot-programin për praktikantë me hendikep në Parlamentin e Skocisë. Qeveria ka mbështetur edhe programin “Qasje në zyrën e deputetit” me qëllim që të shqyrtojnë pengesat në numër më të madh të fushave në Parlament, duke përfshirë edhe pengesat në “rrugën për në karrierën politike”. Rezultati kryesor ishte përgatitja e planit për pengesat me të cilat përballen personat me hendikep.²⁵

Nga gjashtë parlamentet në hulumtim, Parlamenti në Mbretërinë e Bashkuar ka sistem të kuotave për personat me hendikep. Përveç asaj, parlamenti siguron edhe sistem të kuotave për përfshirjen e personave me hendikep në mekanizmin e punës praktike dhe përvojës në shërbimet e Parlamentit.

Edhe krahas detyrimeve në pajtim me Konventën, parlamentet grumbullojnë të dhëna dhe nuk kanë evidencë për përfshirjen e personave me hendikep në përbërjen e tyre. Vetëm 7% nga të punësuarit në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar janë deklaruar se kanë pamundësi, por megjithatë parlamenti thekson se është i vogël numri i personave të cilët janë deklaruar se kanë ndonjë gjendje të hendikepit.

Krahas shembullit me Mbretërinë e Bashkuar, mund të theksohet edhe praktika e mirë e Parlamentit të Izraelit, ku në pajtim me ligjet ekzistuese në shtet, secili institucion duhet të përfshijë persona me hendikep. Praktika në Izrael thekson se krahas politikave në institucion, e rëndësishme është edhe korniza ekzistuese ligjvënëse në shtet.

Në këtë drejtim me qëllim që të promovohet, por edhe të rritet pjesëmarrja dhe përfaqësimi i bashkësisë me hendikep, është e domosdoshme që parlamentet të inicojnë dhe prezantojnë masa që të bëhet jeta politike më tërheqëse për bashkësinë me hendikep (për shembull, prezantimi i kuotave në parlament si deputetë me hendikep, apo kuota për punësimin e personave me hendikep në shërbimet e parlamentit) apo të merren masa për punën praktike dhe stazhin e burrave dhe grave në parlament.

²³ Shihni më shumë: Raporti “Zbutja e rrugës për personat me hendikep drejtë politikës”, 2015 Komisioni për barazi dhe të drejtat e njeriut – Britania e Madhe, 2015, paragrafi 9. I disponueshëm në: < <https://www.equalityhumanrights.com/en/file/4661/download?token=PII5W6zL> >

²⁴ Shihni: Raporti “Zbutja e rrugës për personat me hendikep drejtë politikës”, 2015 Komisioni për barazi dhe të drejtat e njeriut – Britania e Madhe, 2015, E disponueshëm në: < <https://www.equalityhumanrights.com/en/file/4661/download?token=PII5W6zL> >

²⁵ Shihni më shumë: Raporti “Zbutja e rrugës për personat me hendikep drejtë politikës”, 2015 Komisioni për barazi dhe të drejtat e njeriut – Britania e Madhe, 2015, paragrafi 65, e disponueshëm në: < <https://www.equalityhumanrights.com/en/file/4661/download?token=PII5W6zL> >

2.2 Struktura efikase parlamentare

Që të mundën parlamentet që të respektojnë dhe të përforcojnë vlerat e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të së drejtës, nevojitet që të njëjtët të themelojnë struktura të brendshme efikase dhe mekanizma të cilat do u mundësojnë që të përmbushin detyrimet e tyre.

Komesari i lartë për të drejtat e njeriut i KB-së thekson se në kuadër të parlamenteve duhet të themelohen këshilla apo trupa të përhershme përkatëse të cilat do të përfshihen në vëzhgimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve, sidomos atyre që janë të lidhura me reformën zgjedhore²⁶; Në "Parimet themelore të mbikqyrjes parlamentare"²⁷ parlamentet thirren "që të themelojnë dhe/ose përforcojnë strukturat e tyre të cilat do të mundësojnë mbikqyrje të fuqishme mbi detyrimet e tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut".

Në aspekt të promovimit, avancimit dhe mbrojtjes të të drejtave të bashkësisë me hendikep në pajtim me Konventën, parlamentet e shteteve kanë praktika të ndryshme (shihni: Tabelën P2). Disa parlamente formojnë trupa si pjesë e strukturës të tyre. Disa parlamente kanë grupe joformale, të cilat bashkojnë përfaqësuesit e partive politike që të punojnë në çështjen e pamundësisë në bashkëpunim të ngushtë dhe koordinim me OP.

Në Izrael, aktivitetet e parlamentit në punën me personat me hendikep kryesisht janë të drejtuara në Qendrën për vizitorë. Parlamenti Çek thekson se ka nën-komitete në fushën e çështjeve sociale dhe komiteteve për arsim dhe komunikim të cilat punojnë në çështjen e personave me hendikep. Në parlamentin slloven, në punën me personat me hendikep janë të përfshirë disa trupa punues: a) Zyra për marrëdhëniet me publikun, b) Departamenti për marrëdhënie me publikun, protokollin dhe përkthimin, c) Departamenti për shërbimet audivizuele, ç) Departamenti për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e kuvendit kombëtar.

Në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar, PE-së dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë modele të kombinuara.

Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar përmend ekzistimin e "Grupit parlamentar të të gjithë partive (The All Party Parliamentary Groups - APPG) për çështjen e hendikepit, i cili është grupi ndërpartiak i anëtarëve të Parlamentit nga të dy dhomat dhe OPH në Mbretërinë e Bashkuar (Disability Right UK).²⁸ Këto grupe janë formuar në diagnoza individuale dhe probleme shëndetësore. Krahas kësaj grupe, në pyetësor është përmendur edhe Komiteti për gratë dhe barazinë²⁹ ku debatohet çështja e hendikepit dhe³⁰ b) Byroja e Parlamentit³¹ (trupi qeverisës që përbëhet nga kryetari dhe nënkryetari) dhe te ai ekziston grupi i nivelit të lartë për barazi gjinore dhe shumëllojshmëri; c) Komiteti parlamentar për peticione, Komiteti për punësim dhe liritë civile të cilët janë pjesë e kornizës për monitorimin e Konventës, ç) Departamenti për barazi, përfshirje dhe shumëllojshmëri si pjesë e Drejtoratit të përgjithshëm, e) Grupi për mbështetje për çështjen e hendikepit që përfaqëson anëtarët e personelit me hendikep dhe lobon mbi administratën për çështje të interesit për personat me hendikep.

²⁶ Shihni: Navanethem Pillay (2012). Strengthening the United Nations human rights treaty body system. A report by the United Nations High Commissioner for Human Rights, qershor, viti 2012, fq. 85. Të disponueshme në: <https://www2.ohchr.org/english/bodies/HRTD/docs/HCRReportTBStrengthening.pdf>

²⁷ Shihni: Kuvendi parlamentar pranë KE, Rezoluta 1823, 201, E disponueshme në: <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=18011&lang=EN>

²⁸ Shihni: Grupi parlamentar i të gjithë partive, E disponueshme në: <https://www.disabilityrightsuk.org/policy-campaigns/all-party-parliamentary-disability-group-appdg>

²⁹ Shihni: Komiteti për gra dhe barazi, Parlamenti i Britanisë të Madhe. E disponueshme në: <https://committees.parliament.uk/committee/328/women-and-equalities-committee/>

³⁰ Shihni më shumë: Ndër-grupi për çështjen e hendikepit, e disponueshme në: <http://www.edf-feph.org/disability-intergroup-european-parliament>

³¹ Shihni: Byroja e PE, E disponueshme në: <https://www.europarl.europa.eu/about-parliament/en/organisation-and-rules/organisation/political-bodies>

Në Parlamentin e Izraelit ka udhëheqës të departamentit/koordinator për qasshmëri, që është i ngarkuar me detyrë që Parlamenti të jetë i qasshëm për personat me hendikep, duke përfshirë edhe shërbimet të cilat sigurohen në nivel të institucionit. Në pajtim me rregullativën, neni 91, paragrafi 4, preferohet që ky person të jetë person me hendikep . Ky shërbim përbëhet nga disa departamente të cilat përfshijnë shërbimin juridik, ekspertët e jashtëm për çështjen e qasshmërisë funksionale dhe qasshmërisë në shërbime, shërbimi për burimet njerëzore të cilat kujdesen për të siguruar kushtet përkatëse për të punësuarit me hendikep. Puna e këshilltarit dhe vetë shërbimit është që të këshillojnë shërbimet tjera në Kneset për zbatimin efikas të detyrimeve nga ligji, si dhe të përfshijnë inovacione të reja. Vendosja e tillë në parlamentin izraelit rrejdh nga Ligji për të drejtat e barabarta të qytetarëve me hendikep, sipas të cilit “çdo organizatë/institucion publik që siguron shërbime dhe ka 25 apo më shumë të punësuar duhet të caktojë “një nga të punësuarit e saj si këshilltarë për qasshmëri “. ³²

Në parlamentin maqedonas, gjithashtu, veprojnë më shumë trupa punues. IP vepron si njësi e veçantë organizative në Shërbimin e Kuvendit, të cilët realizojnë aktivitete të ndryshme, e në të cilat janë përfshirë personat me hendikep.³³ Në aspekt të trupave punuese në Kuvend, ekzistojnë disa komisione si: Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarit, Komisioni për punë dhe politikë sociale, si dhe Komisioni për mbrojtje shëndetësore, Komisioni për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave dhe të tjerë të cilët në varësi nga iniciativat ndonjëherë e hapin edhe çështjen e pamundësisë. Krahas mekanizmave formale dhe trupave punuese, pas shembullit të PE-së dhe Mbretërisë të Bashkuar, ekziston edhe mekanizmi joformal i GPNP për të drejtat e personave me hendikep (GPNP) i cili në bashkëpunim me OPH punon ekskluzivisht në çështjen e pamundësisë dhe zbatimit të duhur të Konventës.

Në parlamentin maqedonas, gjithashtu, veprojnë më shumë trupa punues. IP vepron si njësi e veçantë organizative në Shërbimin e Kuvendit, të cilët realizojnë aktivitete të ndryshme, e në të cilat janë përfshirë personat me hendikep. Në aspekt të trupave punuese në Kuvend, ekzistojnë disa komisione si: Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarit, Komisioni për punë dhe politikë sociale, si dhe Komisioni për mbrojtje shëndetësore, Komisioni për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave dhe të tjerë të cilët në varësi nga iniciativat ndonjëherë e hapin edhe çështjen e pamundësisë. Krahas mekanizmave formale dhe trupave punuese, pas shembullit të PE-së dhe Mbretërisë të Bashkuar, ekziston edhe mekanizmi joformal i GPNP për të drejtat e personave me hendikep (GPNP) i cili në bashkëpunim me OPH punon ekskluzivisht në çështjen e pamundësisë dhe zbatimit të duhur të Konventës.

³²Shihni: Udhëzimet për veprim të Komiteteve parlamentare pranë PE, të disponueshme në: <http://edf-feph.org/toolkits-meps>

³³Shihni më shumë: Ligji për mundësitë e barabarta të qytetarëve me hendikep , paragrafi 91, alinea 4, E disponueshme në <https://www.aisrael.org/_Uploads/dbsAttachedFiles/Regulations.pdf >

P 2. Cilët subjekte në Parlamentin tuaj janë përfshirë në punën me personat me hendikep (psh., komiteti/komisioni/grupi ndërpartiak parlamentar, grupi joformal/klubi i deputetëve, departamenti/njësia në shërbimin e kuvendit etj.)? Ju lutemi, lirisht zgjeroni listën.

MQ	Grupi ndërpartiak parlamentar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (GPNP) dhe Instituti parlamentar (Njësia e veçantë organizative në Shërbimin e Kuvendit).
BE	Byroja e Parlamentit (trupi udhëheqës që përbëhet nga kryetari dhe nënkryetari) ka grupin në nivel të lartë për barazinë gjinore dhe shumëllojshmërinë, i cili është shumë aktiv në lidhje me çështjen e hendikepit. Parlamenti, gjithashtu është anëtar i Kornizës së BE-së për ndjekjen e pajtueshmërisë me Konventën, ku bëjnë pjesë edhe komitetet për punësim, liritë qytetare dhe peticione. Departamenti për barazi, përfshirje dhe shumëllojshmëri, i cili është pjesë e Drejtoratit të përgjithshëm për personel, përfshin sektorin për hendikep për përballje me të gjithë çështjet e lidhura me hendikepin. Ekziston Grup aktiv për mbështetje që përfaqëson anëtarët e personelit me hendikep dhe lobon në administratë për çështjen e interesit të këtyre anëtarëve të personelit.
IZ	BNë kuadër të Parlamentit, në pajtim me Ligjin për të drejta të barabarta të qytetarëve me hendikep, ka koordinator/ këshilltarë për këtë çështje që koordinon aktivitetet në nivel të të gjithë institucionit dhe u jep këshilla shërbimeve që shërbimet e tyre të jenë të qasshme për personat me hendikep. Preferohet që ky person të jetë person me hendikep (në pajtim me rregullativat). Njëkohësisht, ky person informon shërbimet për detyrimet e tyre në pajtim me Ligjin dhe punon me ato për të harmonizuar politikën e tyre me detyrimet ligjore. Krahas asaj, profesionistët tjerë i ndihmojnë koordinatorit, si në fushën e qasshmërisë ashtu edhe në zhvillimin dhe sigurimin e udhëzimeve të departamenteve të ndryshme në parlament. Në të njëjtën kohë, ky këshilltar me shërbimin e tij bëjnë edhe mbikqyrje të zbatimit të detyrimeve nga ana e shërbimeve. Krahas koordinatorit, në shërbim ka edhe shërbim për burimet njerëzore të cilat janë të orientuara drejtë sigurimit të nevojave të personave të punësuar me hendikep, shërbimi juridik i cili ndjek legjislacionin dhe inicon projekte dhe ndryshime. Në këtë shërbim ka angazhuar dy këshilltarë të jashtëm për qasshmëri profesionale prej të cilëve njëri është specialist për qasshmërinë strukturore dhe funksionale dhe një specialist për qasshmëri në shërbime. Meqënëse fusha e qasshmërisë është e komplikuar, përfshin shumë çështje dhe vazhdimisht përditësohet – edhe nga aspekti i legjislacionit dhe teknologjisë – kjo çështje kërkon përkushtim dhe vëmendje të madhe. Prandaj rekomandohet të paktën një i punësuar të punojë ekskluzivisht në qasshmërinë, ashtuqë ai apo ajo mund të përkushtojë të gjithë kohën dhe vëmendjen kësaj teme, e madje edhe të specializohet dhe të zhvillohet në këtë fushë.
ÇE	Ekzistojnë nënkomitete për shërbimet sociale dhe për personat me hendikep të cilat merren me këtë çështje si rezultat i procesit ligjvënës. Sektori për komunikim dhe arsim ofron shërbime për personat me hendikep si pjesë e aktiviteteve të tij, ekskurzione për publikun e gjërë, simulime, seminare edukative.

<p>MB</p>	<p>Ekzistojnë APPGs për hendikepin specifik: sindromi 22q11; Lëndimet e marra në tru; Kujdesi social për të moshuarit; Plakja dhe persona në moshë më të vjetër; Alergjia ADHD: Autizmi, Aksija Spondilartitis; Humbja e foshnjës të sapolindur; Zgjatja e fshikëzës të urinës dhe zor-rës të trashë; Kancer në gjak; Tumor në tru; Kancer në gj; Kancer; Nevoja komplekse në fund të jetës; Dementia; Diabeti; Aftësitë e kufizuara; Disleksia dhe vështirësitë tjera specifike në mësim; Dispraksija; Çregullime në të ushqyer; Endometrioza; Epilepsia; Pajisje për fëmijët me nevoja të veçanta; Hemofilia dhe gjaku i kontaminuar; Shëndeti; HIV dhe SIDA; Hospis dhe kujdesi për fundin e jetës; Aftësi të kufizuara në mësim; Shëndeti i mëlqisë; Malaria dhe sëmundjet e neglizhuara tropike; Shëndeti mendor; Sëmundja e neuroneve motorike; Multipleks skleroza; Distrofia e muskujve; Encefalomyelitis mielalgjik (EM); Trashësia: Kanceri në vezore; Medicina e personalizuar (MP); Foshnje të lindura para kohe dhe të sëmura; Radioterapia; Shëndeti i frymëmarrjes; Sepsis; Qeliza në formë draperi dhe talasemija; Nevojat speciale arsimore dhe aftësitë e kufizuara; Vështirësitë në të shprehur dhe në folur; Transplantimi i qelizave amë; Tuberkuloza; Programi për shërim në dymbëdhjetë hapa për varësi; Sëmundja vaskulare dhe e venave; Shëndeti i grave; Shëndeti i të rinjve.</p> <p>Kemi komitet për gra dhe barazi ku debatojnë dhe zhvillohen të drejtat e personave me hendikep.</p>
<p>SLL</p>	<p>Zyra për marrëdhënie me publikun e Kuvendit Kombëtar. Departamenti për marrëdhënie ndërkombëtare, protokoll dhe përkthim; Shërbimet audiovizuale të kuvendit kombëtar, Departamenti për përmirësime dhe mirëmbajtje të Kuvendit kombëtar, Zyra për marrëdhënie me publikun në Kuvendin kombëtar</p>

Për shkak të qasjes gjithnjë e më të përfaqësuar mjekësore ndaj çështjes të hendikepit, parlamentet përmes trupave të vendosur të punës përpiqen që të përafrojnë deri te modeli social ndaj çështjes të hendikepit. Por, duhet patur kujdes në faktin se çështja e pamundësisë dhe zbatimi i Konventës është shumë më shumë se vetëm sigurimi i qasshmërisë apo sigurimit të përfitimeve të caktuara vetëm për diagnozën e caktuar. Në këtë drejtim çdo parlament kombëtar, e duke patur parasysh përfshirjen e Konventës, duhet të vendos praktikën që çdo trup punues të ketë detyrimin që në secilin fushëveprim të punës të inkorporojë çështjen e pamundësisë dhe dispozitat e Konventës.

Deputetët përmes komiteteve të tyre përveç përmes pjesëmarrjes në debate dhe përfshirje në përfaqësimin aktiv në emër të individëve dhe/ose grupeve, kanë në dispozicion një spektër të mekanizmeve që mund të shfrytëzohen për ngritjen e vetëdijes për çështjet e të drejtave të njeriut për bashkësinë me hendikep. Këto mekanizma mund të jenë mjete për sigurimin e informatave për çështjet që lidhen me të drejtat e bashkësisë me hendikep, për sqarimin e politikës qeveritare dhe tërheqjen e vëmendjes për këtë çështje si dhe për ngritjen e vetëdijes.

Si pjesë e kornizës institucionale për monitorim të Konventës në kuadër të PE-së, Komiteti Parlamentar për peticione (PETI) kryen rolin specifik në emër të PE-së për mbrojtjen e të drejtave të bashkësisë me hendikep në pajtim me nenin 33 të Konventës. Mandati i PETI i referohet si mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave nga Konventa nga ana e vendeve anëtare gjatë zbatimit të ligjeve por edhe më gjërë, në aspekt të harmonizimit nga ana e institucioneve të BE-së, në cilindo prej funksioneve të tyre me Konventën.³⁴

³⁴ Shihni: Raporti i PETI, PE, I disponueshëm në <https://www.eumonitor.eu/9353000/1/j9vwik7m1c3gyxp/vh7ykb9uyqyu>

Komiteti i përbashkët për të drejtat e njeriut është një shembull tipik i modelit të specializuar të këshillit për të drejtat e njeriut (JCHR)³⁵. Me punën e tij ka filluar në vitin 2001 dhe përbëhet prej 12 anëtarëve, të cilët në mënyrë të barabartë vijnë nga rradhët e Dhomës të poshtme dhe nga rradhët e Dhomës të lordëve. JCHR insiston që të ketë nga dy deri në tre këshilltarë të paraparë juridik me ekspertizë për të drejtat e njeriut të cilët shërbimet e tyre ua japin anëtarëve të JCHR. Fushëveprimi formal i komitetit është në veçanti i gjërë dhe përfshin çështjet në lidhje me të drejtat e njeriut në Mbretërinë e Bashkuar, me përjashtim të rasteve individuale. Mes aktiviteteve tjera, komiteti: - kryen kontroll themelor të reagimit të pushtetit ekzekutiv pas paragjytimeve të Gjykatës në bazë të kriterëve të vendosura nga JCHR; për shembull, kërkesa që qeveria të përgatis një plan të detajuar për reagimet e saj në afat prej katër muajsh dhe të marrë vendim përfundimtar për të përmirësuar mospërputhjen në afat prej gjashtë muajsh; bën hetime tematike për çështjet për të cilat ekziston arsye për shqetësim për të drejtat e njeriut, duke kërkuar dëshmi të përfshirjes të gjërë të grupeve dhe individëve të cilët disponojnë me përvojat përkatëse dhe interesat; dhe në mënyrë selektive vëzhgon respektimin nga ana e Mbretërisë të Bashkuar të detyrimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në pajtim me marrëveshjet e KB-së për të drejtat e njeriut.

Komiteti i përbashkët³⁶ për të drejtat e njeriut pranë Mbretërisë të Bashkuar ka inicuar hetime për qasjen e personave me vështirësi në arsim në vitin 2007, Komiteti jep rekomandime dhe vërejtje, duke përfshirë dhe parashtrimin e kërkesave të Mbretërisë të Bashkuar që të ratifikojë Konventën pa rezerva. Në vitin 2011, Komiteti i përbashkët për të drejtat e njeriut ka inicuar hetimin për zbatimin e të drejtës të jetës të pavarur të personave me hendikep, në pajtim me nenin 19 të Konventës.

Në numrin më të vogël të vendeve, ekzistojnë edhe grupe joformale. I tillë është grupi ndërpartiak për çështjen e pamundësisë pranë PE-së, Grupi parlamentar për çështjen e hendikepit në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe Grupi parlamentar ndërpartiak për të drejtat e personave me hendikep GPNP. Këto grupe janë të koordinuara nga OPH duke ndjekur parimin "Asgjë për ne – pa ne". Në Mbretërinë e Bashkuar ky është Grupi për çështjen e hendikepit, në nivel të BE-së – Forumi European për çështjen e hendikepit, kurse në RMV koordinimin e udhëheq Polio Plus. Për dallim nga Mbretëria e Bashkuar dhe BE-së, ku organizatat janë të mbështetura financiarisht nga ana e Qeverisë, puna e GPNP në Republikën e Maqedonisë së Veriut është pa mbështetje nga Qeveria.

Nga viti 2003, me iniciativë të Polio Plus – Lëvizja kundër hendikepit, është formuar Grupi ndërpartiak parlamentar për të drejtat e personave me hendikep – GPNP. Në 17 vitet e kaluara, në Kuvend, grupi vepron si grup joformal i përbërë nga deputetët e të gjithë partive politike. Roli i tij kryesorë është që të artikulojë nevojat e personave me hendikep në organin ligjvënës, para përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv, si dhe të përfshijë në rrjedhat kryesore çështjen e hendikepit.

Me propozim të GPNP-së, Kuvendi në vitin 2003, ka miratuar Deklaratën për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave me hendikep.

Me propozim të GPNP-së, kurse në bashkëpunim me Polio Plus dhe Delegacionin e BE-së në Shkup, në vitin 2006 është siguruar mbështetja në Parlament për vendosjen e platformave, sigurimin e rampave (platformave të pjerrëta) si dhe shënimin e vendeve të parkimit për personat me hendikep.

³⁵ Shihni faqen e internetit të JCHR në <https://committees.parliament.uk/committee/93/human-rights-joint-committee>

³⁶ Shihni: Të drejtat e njeriut dhe parlamentet, Doracak për të punësuarit dhe anëtarët e parlamenteve, Uestminster Konzorcium, viti 2011, e disponueshme në: < <https://www.ibanet.org/Document/Default.aspx?DocumentUid=7B0B2D39-F3EC-4724-B797-C3CB68C51B57> >

Me propozim të Polio Plus dhe anëtarëve të GPNP-së është përgatitur ligji sistemor për të drejtat e personave me hendikep. Deputetët bashkarisht me personat me hendikep kanë vendosur që të dalin në terren dhe të iniciojnë iniciativën e parë qytetare për miratimin e ligjit sistemor. Në vend të 10.000 nënshkrimeve të nevojshme, iniciativa qytetare është mbështetur me nënshkrime zyrtare nga 19.875 qytetarë. Në vitin 2006, Kuvendi pas parashtrimit të propozim-ligjit me aklamacion ka votuar nevojën për miratimin e një ligji të tillë.

GPNP në mënyrë aktive ka lobuar dhe përfaqësuar përmes fushatave “Konventë tani” të Polio Plus, kurse për të siguruar ratifikimin e Konventës pa asnjë rezervë.

Gjatë këtyre 17 viteve GPNP ka parashtruar më shumë se 80 iniciativa dhe amendamente. Në raportin e FRA³⁷ për vitin 2019, GPNP është përmendur si shembull pozitiv për bashkëpunim dhe mekanizëm për ndryshim të legjislacionit dhe promovim të detyrimeve nga Konventa.

Në vitin 2019 me iniciativë të GPNP-së është përgatitur dhe votuar me aklamacion Deklarata për pjesëmarrje politike të qytetarëve me aftësi të kufizuara.

Edhe krahas karakterit joformal, këto grupe kanë ndikim të madh në sensibilizimin e çështjes të hendikepit në Parlament, si dhe për ndryshimin e vetëdijes publike, por edhe për inicimin e iniciativave për zbatimin e detyrimeve nga Konventa. Këto grupe janë mekanizëm i mirë për të ndikuar dhe për ndryshuar kulturën politike në partitë politike dhe përfshirjen e dispozitave nga Konventa në fushëveprimin e programeve të tyre politike.

Parlamentet kanë praktikë të ndryshme në aspekt të avancimit të të drejtave të personave me hendikep dhe vendosjen e strukturës parlamentare e cila në mënyrë efikase inkorporon detyrimet nga Konventa. Një pjesë më e madhe e komiteteve parlamentare pranë PE-së në punën e tyre përfshijnë çështjen e pamundësisë dhe të njëjtët kanë miratuar plane për veprim në drejtim të avancimit të të drejtave të personave me hendikep që është praktikë e mirë për përfshirjen dhe angazhimin e strukturave ekzistuese në parlamente dhe të inkorporojnë çështjen e hendikepit në fushëveprimin e punës së tyre.

Në mënyrë shtesë, praktikë e mirë është edhe ajo në Izrael me angazhimin e këshilltarit dhe/ose koordinatorit me të gjithë shërbimin që punon dhe i jep mbështetje Parlamentit për çështjet e hendikepit, nga aspekti i qasshmërisë deri te, dhe në objekte, por edhe në shërbime dhe u siguron mbështetje të punësuarve me hendikep.

Mekanizmat joformale (GPNP në parlamentin maqedonas, grupet parlamentare pranë Mbretërisë të Bashkuar dhe Grupi ndërpartiak pranë PE-së) janë shembull i mirë për veprimin e përbashkët të OPH-së me vetë deputetët, të cilët artikulojnë zërin e tyre në seancat e kuvendit dhe llobojnë dhe avokojnë për të drejtat e tyre.

Problem te këto mekanizma paraqet mbështetja për OPH-në, e cila te këto mekanizma siguron të gjithë mbështetjen teknike, të ekspertëve dhe juridike.

³⁷ Shihni më shumë: Raporti i FRA-së për të drejtat themelore të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, E disponueshme në: <<https://fra.europa.eu/en/country/north-macedonia>>

2.2.1 Mbështetje për deputetët për çështje në lidhje me Konventën

Për punë efikase dhe funksionalitet të parlamenteve, është shumë i rëndësishëm edhe efikasiteti dhe profesionalizimi i shërbimeve. Në kuadër të parlamenteve miratohen dokumente të ndryshme strategjike me të cilat rregullohen çështjet e ndryshme në aspekt të veprimit sektorial, si dhe komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm. Nëse e shohim edhe nga aspekti i Konventës, të gjithë aktet të cilat i referohen organizimit të brendshëm, është e domosdoshme që të jenë harmonizuar me Konventën, kurse të njëjtat është e domosdoshme që të rregullojnë mënyrat e rekrutimit, punësimit dhe angazhimit të personave me hendikep në sektorët e ndryshëm.

Në këtë kontekst është vendosur pyetja për sigurimin e trajnimeve për shërbimet, sektorët, apo njësitë e veçanta organizative në parlament për çështjen e hendikepit (Shihni Tabelën P2.1), tre(3) parlamentet janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa tre (3) parlamente janë përgjigjur negativisht.

Në trajnimet që kanë realizuar parlamentet e Mbretërisë të Bashkuar, të Izraelit dhe PE-së, janë përfshirë edhe shërbimet të cilat janë në "rradhët e para" në komunikim me njerëzit e jashtëm. Temat për të cilat trajnohen personat nga shërbimet dhe në tre parlamente janë të lidhura me sigurimin e qasshmërisë dhe përshtatjes përkatëse të vizitorëve me hendikep, qasje dhe komunikim me të njëjtat.

Në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar nga agjencia e specializuar sigurohet trajnimi "online" deri te i cili mund të qasen të gjithë të punësuarit dhe i njëjti i referohet për qasje dhe komunikim personave me hendikep. Në parlamentin izraelit, në pajtim me Ligjin ekzistues për të drejta të barabarta të qytetarëve me hendikep dhe detyrimet për harmonizim për qasje në shërbime 5773-2013³⁸, të gjithë të punësuarit në shërbimet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe gjykatat, kanë trajnime për çështjen e qasshmërisë, përshtatjes përkatëse, qasjes në shërbime, duke përfshirë etiketën dhe komunikimin me personat me hendikep.

Në pajtim me detyrimet ligjore, çdo i punësuar duhet të kalojë trajnimin për çështjen e hendikepit, si dhe inovacionet dhe teknologjitë e reja të cilat zbatohen për qasshmëri në shërbime. Shërbimet të cilat punësojnë më shumë se 25 persona janë të detyruara që të përgatisin plan për trajnime, i cili miratohet nga Komisioni për të drejta të barabarta të personave me hendikep i cili vepron në kuadër të Ministrisë të drejtësisë.³⁹

P2.1. A kanë marrë të punësuarit në shërbimin e kuvendit trajnimin themelor për të drejtat e personave me hendikep, duke përfshirë edhe përdorimin përkatës dhe të drejtë të gjuhës? Nëse po, kush e organizoi dhe zbatoi trajnimin (universitetet, shoqatat qytetare, edukatorët e specializuar, etj.)?

MQ	Jo
BE	Anëtarët e personelit të angazhuar për pranim të vizitorëve në Kuvend kanë marrë trajnimin themelor për qasshmëri, nga kompania e specializuar.

³⁸ Shihni më shumë: Ligji për të drejta të barabarta të qytetarëve me hendikep, paragrafi 90. I disponueshëm në <https://www.aisrael.org/_Uploads/dbsAttachedFiles/Regulations.pdf>

³⁹ Shihni më shumë: Komisioni për të drejta të barabarta të personave me hendikep. I disponueshëm në: <https://www.gov.il/en/departments/about/about_the_commission>

IZ	Të gjithë të punësuarit kalojnë trajnimin e përgjithshëm në temën e qasshmërisë, kurse të punësuarit të cilët janë ofrues të drejtëpërdrejtë të shërbimeve (udhërrëfyesit e Qendrës për vizitorë, anëtarët e gardës të Kneset) marrin trajnim shtesë në punëtorinë e përgatitur në mënyrë speciale. Çdo i ri i punësuar në Kneset kalon në trajnim për qasshmëri në periudhën kohore të përkufizuar në procedurat e Kneset (në pajtim me dispozitat nga rregullativat për përshtatjen e qasshmërisë në shërbime). Seancat shtesë për trajnim për qasshmëri mbahen në mënyrë periodike sipas nevojës. Kështu, për shembull, udhëzimet për udhëheqësit e Qendrave për vizitorë kanë trajnim të specializuar për ashensorët operativ në ndërtesën e Kneset.
ÇE	Jo
MB	Po, i gjithë personeli që punon në departamentin për pranim dhe komunikim ka trajnim për çështjet në lidhje me hendikepin dhe përzgjedhjen e drejtë të gjuhës. Ekziston trajnimi përmes internetit për çështjen e hendikepit deri te i cili mund të qasen të gjithë të punësuarit, që është dizajnuar nga edukatorë të specializuar.
SLL	Nuk ka informata

Dy parlamente nuk japin informata për atë nëse njerëzit që janë të përfshirë në punën me personat me hendikep kanë marrë trajnime të specializuara apo kanë përvojë më mëparshme gjatë punës në këtë fushë (Shihni: Tabelën P2.2) Katër parlamentet tjera (Kuvendi i RMV-së, Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar, i Izraelit si dhe i Çekisë), theksojnë se personat e caktuar në sektorët e ndryshëm në shërbimet parlamentare marrin trajnime të ndryshme. Parlamenti maqedonas thekson se është organizuar trajnim tematik në vitin 2019, për anëtarët e GPNP-së në çështjen e pjesëmarrjes politike të personave me hendikep, të cilin e ka realizuar Polio Plus me mbështetje nga OSBE. Parlamenti i Izraelit thekson se sigurohet trajnim i specializuar për personat të cilët u shërbejnë vizitorëve me hendikep në Parlament, por edhe për të gjithë të punësuarit në shërbimet e ndryshme në pajtim me rregullativën e tyre.

P 2.2. A ka marrë pjesë dikush prej personave të përfshirë në punë me personat me hendikep në trajnimet e specializuara apo kanë përvojë paraprake në këtë fushë? Nëse po, kush organizonte dhe realizonte trajnimet (universitetet, organizatat qytetare, edukatorët e specializuar, etj)? Kush mernte pjesë në trajnime (deputetët, të punësuarit, udhërrëfyesit turistik, etj.)?

MQ	Deputetët nga GPNP kanë marrë pjesë në trajnim me temë "Pjesëmarrja politike e personave me hendikep" të mbështetur nga OSBE dhe Polio Plus në mars të vitit 2019.
BE	/
IZ	Po, në pajtim me detyrimet nga rregullatit ligjore, personat e caktuar në shërbim marrin trajnime të specializuara për çështjet e caktuara në lidhje me qasshmërinë dhe shërbimet ndaj personave me hendikep
ÇE	Zyra e Dhomës të poshtme e deputetëve ka të punësuar në vendet e punës të cilat u përgjigjen aftësive të tyre dhe përgatitjes mjekësore sipas raportit mjekësorë të lëshuar nga ofruesi i kujdesit shëndetësorë gjatë punës.
MB	Po, udhërrëfyesit turistik, deputetët e rinj të cilët janë zgjedhur në çdo zgjedhje. Në zgjedhjet e fundit, grupi i specializuar ishte trajnuar që tu ndihmojë deputetëve me hendikep në lidhje me qasshmërinë. Kemi organizata bamirësie të cilat na këshillojnë si më së miri të bashkëpunojmë me grupet me hendikep, për shembull, me gjendjet e ndryshme neurologjike.
SLL	Nuk ka informata

Ngjajshëm si në Izrael edhe në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar organizohen trajnime për udhërrëfyesit të cilët organizojnë vizita në kuvend, trajnime për personat të cilët japin mbështetje për deputetët me hendikep. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar thekson se bashkëpunon me organiza-

ta të cilat këshillojnë se si të bashkëpunojnë me persona me gjendje të ndryshme të hendikepit. Në aspekt të organizatorëve dhe realizuesve, në trajnime, parlamentet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Mbretërinë e Bashkuar theksojnë se për këtë bashkëpunojnë me organizata të ndryshme të personave me hendikep.

Parlamenti duhet të jetë i qasshëm për bashkësinë me hendikep, pa dallim nëse personi me hendikep do të vijë si vizitorë, në takim me deputetin, do të jetë deputet apo pjesë e shërbimit të parlamentit. Si me shembullin e Mbretërisë të Bashkuar, edhe IP në kuvendin maqedonas ofron trajnime për deputetët e rinj, trajnime për çështje të ndryshme dhe parashtron analiza të ndryshme me kërkesë të deputetëve. Me qëllim që të arrihet koherencë më e madhe dhe të kuptueshme të gjithëpërfshirjes të Konventës, është e domosdoshme që në planet e tyre vjetore, programet dhe trajnimet, të përfshihen edhe çështje e hendikepit.

Megjithatë shembulli i Izraelit është mjaftë solid edhe nga aspekti i sigurimit të trajnimit sistematik dhe të vazhdueshëm për të gjithë të punësuarit, madje edhe për vullnetarët për sigurimin e qasshmërisë funksionale dhe mënyrës të sigurimit të përshtatjes përkatëse.

Megjithatë, krahas këtyre fushave tematike është e domosdoshme që të organizohen edhe trajnime sistematike për deputetët, si dhe për shërbimet juridike të cilat japin mbështetje për deputetët në tema të ndryshme dhe fusha të cilat i mbulon Konventa, si për shembull qasja në barazi inkluzive apo tema për jetë të pavaur të komunitetit me hendikep.

Shërbimet profesionale në parlamente nuk kanë qasje sistematike drejtë sigurimit të trajnimit përkatëse për detyrimet të cilat rrjedhin nga Konventa, më përjashtim të Mbretërisë të Bashkuar dhe Izraelit. Praktika thekson se pjesa më e madhe e shërbimeve në parlamente kanë trajnime ad hoc për shërbimet profesionale, me përjashtim të Izraelit ku kjo çështje është rregulluar me ligj. Bashkëpunimi i parlamenteve me OPH-në është ad hoc, në varësi të ngjarjeve dhe aktiviteteve që planifikohen që të realizohen. Në parlamente nuk ekziston qasja sistematike për ngritjen e njohurive të deputetëve dhe shërbimeve juridike në fusha të ndryshme dhe tema nga Konventa.

2.3. Komunikimi që është i qasshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë

Kur parlamentet zhvillojnë protokolle të ndryshme për komunikim, është shumë i rëndësishëm miratimi i qasjes universale nga fillimi që do të sigurojë qasje në informata, por, gjithashtu, do të sigurojë transparencë më të madhe të institucionit.

Në këtë drejtim, grupi i tretë i pyetjeve në analizë është pikërisht reth qasshmërisë të informatave dhe praktikave të cilat i kanë vendosur parlamentet.

Në pyetjen (Shihni: Tabelën P3), Nëse parlamentet kanë strategji për komunikim, që përfshin edhe çështjen e komunikimit dhe kontaktit me personat me hendikep, nga katër (4) parlamente vetëm parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar dhe Izraelit thekson se kanë strategji të tillë apo rregullativë në të cilën janë përfshirë personat me hendikep.

Në kryerjen e rolit mbikqyrës të këshillit të Dhomës të poshtme sigurohet përshtatja përkatëse për personat me hendikep të cilët janë paraqitur si dëshmitarë⁴⁰.

Rregullativa në Izrael e përpunon në detaje detyrimin për të siguruar qasje në shërbime të cilat i siguron çdo institucion, duke përfshirë edhe Parlamentin. Për nevojat e Parlamentit është përgatitur udhërrëfyeni në të cilin janë shpjeguar të gjithë elementet, duke përfshirë edhe shërbimet e komunikimit dhe pajisja e cila mund të sigurohet për personat me hendikep sensorik, si dhe personat me hendikep fizik, intelektual dhe psikosocial.

⁴⁰Shihni: Udhërrëfyeni për dëshmitarë të cilët japin dëshmi me gojë apo me shkrim deri të këshilli i Dhomës të poshtme të Komitetit. E disponueshme në: <<https://www.parliament.uk/globalassets/documents/commons-committees/witnessguide.pdf>>

Në mënyrë paralele, Parlamenti i Izraelit ka përgatitur edhe mjetin në formë të videos në të cilin janë shpjeguar të gjithë shërbimet dhe elementet e përshtatjes përkatëse të cilat mund t'ju mundësohen personave me gjendje të ndryshme të hendikepit.

P 3. A ka Parlamenti i juaj strategji për komunikim që përfshin kontaktin me personat me hendikep?

MQ	Jo
BE	Nuk ka strategji specifike
IZ	Në pajtim me rregullativën ekzistuese, çdo departament ka për detyrim të përgatis planin për qasshmëri dhe komunikim të personave me hendikep. Revizioni i të njëjtave bëhet nga ana e Komisionit për të drejta të barabarta të personave me hendikep.
ÇE	Punojmë në strategjinë për komunikim në të cilën do të përfshihen personat me hendikep
MB	Po, kemi strategjinë që përfshin kontaktin me personat me hendikep
SLL	Shihni P 4.1.

Në aspekt të promovimit të aktiviteteve dhe projekteve dhe aktiviteteve të cilat i ndermerr parlamenti dhe si të njëjtat i integrojnë personat me hendikep (shihni: Tabelën P3.1), parlamentet theksojnë qasje të ndryshme.

Parlamenti maqedonas thekson se promovimi i aktiviteteve dhe informatave bëhet përmes rrjeteve sociale dhe faqeve të internetit në Parlament. PE thekson se shfrytëzojnë kanalet standarde të komunikimit. Parlamenti Çek përmend qasjen individuale dhe se informatat i siguron me kërkesa individuale. Parlamenti Slloven siguron interpretimin e gjuhës sllovene të shenjave në takimet e grupeve të punës apo takime tjera sipas kërkesës të mëparshme, sigurojnë pajisje teknike e cila iu mundëson personave me dëgjim të dëmtuar të ndjekin seancat në Kuvend. Gjitashtu, mundësojnë që edhe qeni udhërrëfyes të hyjë në Kuvend.

Promovimi i aktiviteteve nga ana e parlamenteve, më së shpeshti bëhet përmes rrjeteve të tyre sociale, faqeve të internetit dhe materialeve të ndryshme që janë ekskluzivisht të parapara për personat me hendikep. Gjithashtu, një pjesë e madhe të promovimit të aktiviteteve, parlamentet e bëjnë edhe përmes takimeve të ndryshme, ngjarjeve vetëm për persona me hendikep, por edhe ngjarjeve dhe takimeve me kategori të ndryshme të personave me hendikep. Kështu, për shembull, në kohën e "Javës të Parlamentit", parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar bashkëpunon me organizatat bamirëse dhe organizatat e specializuara që të përfshijnë personat me hendikep.

Shembull i mirë është edhe praktika e parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar, përmes të cilës organizohen punëtori për personat me hendikep, gjendje të ndryshme të hendikepit, përmes të cilës personat me hendikep njihen me rolin, punën e parlamentit, mënyrat e komunikimit, mënyrat për kontakt me deputetët etj. Për këto aktivitete kanë përgatitur edhe videomaterialin dhe spote me të cilat inkurajohen personat me hendikep që të njihen më shumë dhe të jenë të interesuar për punën e parlamentit.⁴¹

⁴¹Shihni më shumë: Video materiali i parlamentit pranë Mbretërisë të Bashkuar për promovimin e aktiviteteve të parlamentit: "Të të inkurajoj ty që të inkurajojë të tjerët", E disponueshme në: <https://www.youtube.com/watch?v=zp6yt8t2VsY>

Gjithashtu, praktikë e mirë është ajo e Parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar të cilët përpunojnë materiale dhe broshura të ndryshme me tematikë të ndryshme, në të cilat janë përfshirë edhe personat me hendikep. Në vitin 2020 me rastin e “Muajit të historisë për çështjen e hendikepit 2020” Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar ka përgatitur librin “Tregimi yt – historia jonë!” që përmban tregime për personat të cilat kanë pasur ndikim mbi ligjet në Mbretërinë e Bashkuar, e që janë të lidhura me çështjen e hendikepit dhe të drejtat e njeriut. Është interesante se ky libër është paraparë për grupin e fëmijëve të moshës prej 7 deri në 11 vjet .⁴²

P 3.1. Si do të promovoni dhe siguronit publicitet për aktivitetet dhe projektet që i ndërmerret Parlamenti i juaj dhe të cilat janë të parapara për personat me hendikep?

MQ	Kanalet normale të komunikimit
BE	Të gjithë informatat për qasshmëri të Knesetit lehtësisht mund të gjenden në ueb-faqen zyrtare. Gjithashtu, faqja zyrtare në Jutjub e Knesetit përmban video-promotive për qasje në Kneset.
IZ	Gjithçka bazohet në qasjen individuale. Aktivitetet dhe projektet të cilat i krahasojmë janë të disponueshme për personat me hendikep në bazë të kërkesave individuale.
ÇE	Gjatë kohës të javës parlamentare, kontaktojmë me organizata të ndryshme bamirëse dhe grupe të specializuara që t’i përfshijmë në Parlamentin tonë.
MB	За време на парламентарната недела, контактираме со многу различни добротворни организации и специјалистички групи за да ги вклучиме во нашиот Парламент.
SLL	Nga viti 2002, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhës sllovene të shenjave dhe pas marrëveshjes paraprake, Kuvendi kombëtar u siguron përkthim në gjuhën sllovene të shenjave të gjithë të ftuarve në takimet e grupeve punuese apo ngjarjeve tjera. Personat e verbër mund të hyjnë në Kuvendin kombëtar bashkarisht me qentë e tyre udhërrëfyes. Pajisja teknike për dëgjim (induksion) për personat me dëgjim të dëmtuar është instaluar në ballkonin e Sallës të madhe të Kuvendit kombëtar dhe u mundëson personave me dëgjim të dëmtuar që të ndjekin seancën. Në Sallën e madhe dhe në të gjithë hapësirat për takime të Kuvendit kombëtar ka edhe FM-sistem me transmetues dhe katër pranues pa rrjet, të cilat funksionojnë vetëm kur sistemi i konferencës është përfshirë në hapësirën e caktuar për takime.

Parlamentet theksojnë se materialet e tyre nuk janë të disponueshme në formate që janë lehtësisht të lexueshme (Shihni: Tabelën P.3.2) me përjashtim të Parlamentit në Mbretërinë e Bashkuar dhe Parlamentin e Izraelit. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar thekson se e gjithë literatura e tyre është bërë më lehtësisht e kuptueshme (Shihni: Tabelën P3.3). Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar thekson se Dokumentet të cilat janë krijuar në parlamentin tonë janë të disponueshme për lexuesit e ekranit. Shërbimi ynë digjital siguron lexues të specializuar të ekranit dhe softuer me harduer specifik që nuk janë gjithmonë kompatibil, por i përmërojmë proceset që të vërtetohet se janë përkatëse për këtë destinim. Softuerët më të rinj kanë opsion për leximin automatik të titujve dhe shkrimit të materialit.

⁴² Shihni më shumë: “Tregimi yt – historia jonë!” Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar, 2020, E disponueshme në : < <https://learning.parliament.uk/en/resources/disability-illustrated-book/> >

P 3.2. A janë të disponueshme materialet për komunikim në Parlament në format që është lehtësisht i lexueshëm?

MQ	Jo
BE	Jo
IZ	Ueb-faqja e Kneset është e qasshme. Udhërrëfyesi për parlamentin është në format që është lehtësisht i lexueshëm.
ÇE	E përgatisim këtë formë.
MB	E kemi bërë të gjithë literaturën tonë më të lehtë për t'u kuptuar, ashtuqë është më e disponueshme për secilin. Më parë kishim literaturë që ishte lehtësisht e lexueshme, por është zëvendësuar me material të ri, i cili është më i disponueshëm për secilin pa theksuar se është i lehtë për lexim.
SLL	Nuk ka informata

P 3.3. A janë dokumentet e krijuara në Parlamentin e Juaj, siç janë Word, Excel, PDF dhe materiale të ngjajshme elektronike, të disponueshme për lexuesit e ekranit?

MQ	Dokumentet janë të disponueshme vetëm përmes internetit.
BE	Punohet në këtë fushë, por ka ende përmirësime të cilat duhet të bëhen.
IZ	Dokumentet që krijohen janë të disponueshme në formate të ndryshme.
ÇE	Përgatitemi për verzionin-onlajn të videomaterialit me mbishkrim.
MB	Dokumentet të cilat janë krijuar në parlamentin tonë janë të disponueshme për lexuesit e ekranit. Shërbimi jonë digjital siguron lexues të specializuar të ekranit dhe softuer dhe harduer specifik që nuk janë gjithmonë kompatible, por i përmirësojmë proceset që të vërtetohet se janë përkatëse për këtë destinim. Softuerët më të rinj kanë opsion për lexim automatik dhe shkrim të materialit.
SLL	Nuk ka informata

Nga aspekti i përfaqësimit gjinor dhe promovimit të kulturës të personave me hendikep, me çrast kërkohet në materialet promovuese krahas fotografive nga personat pa hendikep që të jenë përfshirë dhe fotografi nga personat me hendikep, parlamentet nuk posedojnë materiale të tilla (Shihni: Tabela P3.4). PE nuk thekson se "ekzistojnë udhëzime të përgjithshme që të vërtetohet se materialet promovuese pasqyrojnë vlerat e BE-së, më saktësisht vlera që të jemi "të bashkuar në diversitet". Ekzistojnë edhe udhëzime specifike për komunikim përfshirës për komunikim të jashtëm të cilat japin këshilla specifike për përfshirjen e personave me hendikep. Gjithashtu, në nivel të PE është miratuar fjalori me terminologji për respektimin dhe përfshirjen që përdoret gjatë komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar thekson se këtë e bën kur organizon vizita të parlamentit dhe në një pjesë të materialit të tyre promovues.

Parlamenti i Izraelit ka përgatitur udhërrëfyesin në të cilin janë theksuar elementet për përshtatjen e duhur, të ilustruara me fotografi nga burrat dhe gratë me hendikep.

P 3.4.A përfshijnë materialet promovuese me tekst dhe fotografi të burrave dhe grave me hendikep?

MQ	Jo.
BE	Konkretisht jo. Ekzistojnë udhëzime të përgjithshme që të vëretohet se materialet promovuese pasqyrojnë vlerat e Bashkimit Europian, më saktësisht vlera për të qënë "të bashkuar në dallime". Ekzistojnë edhe udhëzime specifike për komunikimin përfshirës, për komunikimin e jashtëm, të cilat japin këshilla specifike për përfshirjen e personave me hendikep. Më së fundi është miratuar fjalori me terminologjinë për respektimin dhe përfshirjen që duhet të përdoret edhe gjatë komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.
IZ	Broshura për qasshmëri në Parlament përmban fotografi nga burra dhe gra me hendikep.
ÇE	E përgatisim këtë formë.
MB	Po, për vizita dhe në materialin tonë promovues.
SLL	Nuk ka informata

Në aspekt të sigurimit të titrave apo përkthimit të video shënimit (Shihni: Tabelën P3.5) të parlamenteve, situata është e ngjajshme. Pesë parlamente theksojnë se nuk kanë siguruar tituj apo përkthim të videos, më përjashtim të Parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar që thekson se ka standard për atë, që është pjesë e strategjisë të tyre.

Parlamentet në përgjithësi nuk sigurojnë shënime audio (Shihni: Tabelën P3.6) nga seancat dhe materialet dhe informatat të cilat i publikojnë, me përjashtim të Parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar, ku gjuha angleze e shenjave sigurohet gjatë kohës të pyetjeve të deputetëve në Dhomën e poshtme⁴³. PE thekson se për momentin nuk është i mundshëm realizimi i përkthimit dhe titujve të videove për shkak të përdorimit të 23 gjuhëve zyrtare në nivel të Bashkimit Europian.

P 3.5. A janë titrat dhe/ose përkthimet pjesë nga videot parlamentare?

MQ	Jo.
BE	Për momentin jo. Parlamenti është një organizatë shumëgjuhësore me 23 gjuhë zyrtare, fakt që në mënyrë të konsiderueshme e komplikon procesin.
IZ	Videoja e vetme që përmban përkthim është videoja promovuese për qasje në Kneset, https://www.youtube.com/watch?v=3NEVD7rXhWw .
ÇE	Jo
MB	Po, si standard.
SLL	Nuk ka informata.

P3.6. A janë shënimet audio pjesë e videove të kuvendit?

MQ	Jo.
BE	Jo, për shkak të të njëjtës arsye.(P 3.5)
IZ	Jo.
ÇE	Jo.
MB	Shënimet audio dhe gjuha britanike e shenjave tani përdoren për pyetje të deputetëve.
SLL	Nuk ka informata

⁴³Shihni më shumë në: <https://www.parliament.uk/business/news/2020/february/pmq-british-sign-language/>

Kur bëhet fjalë për informata të specializuara, edukative apo prodhime promovuese të destinuar për personat me hendikep (për shembull: video edukuese, posterë promotiv, fletushka, materiale të shkrimit Braj etj.), parlamentet në këto gjashtë shtete kanë përgatitur shumë materiale të cilat janë destinuar për personat me hendikep (Shihni: Tabela P 3.7). Parlamenti maqedonas thekson se “Njësia për edukim dhe komunikim të IP ka përgatitur posterë edukative në gjuhën e shenjave dhe materiale arsimore (lista të fakteve) të shkrimit braj dhe në formë audio. Te posterët përdoren fotografi dhe tekst në gjuhën e shenjave që të përshkruhen nocionet: Kuvendi (parlamenti), deputeti, Kushtetuta, Ligji, demokracia dhe zgjedhjet”. Nga Parlamenti Slloven theksohet se “në vitin 2010 kanë përgatitur broshurën për Kuvendin kombëtar të shkrimit braj në bashkëpunim me Shoqatën e të verbërve dhe personave me shikim të dobët të Sllovenisë, kurse në vitin 2011, Kushtetuta është shpallur në shkrimin Braj.”

Në bazë të përgjigjeve të marra nga parlamentet mund të vërehet se të njëjtat në mënyrë ad hoc qasen në sigurimin e informatave të qasshme dhe të disponueshme për bashkësinë me hendikep. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar ka standard të caktuar për komunikim, por i njëjti nuk zbatohet në format të sistemit por në zona të caktuara.

P 3.7. A përgatit dhe shpërndan parlamenti juaj çfarëdo prodhime të specializuara informative, edukuese apo promovuese të destinuar për personat me hendikep (për shembull, video edukative, posterë promovues, fletushka, materiale të shkrimit braj, etj.)? Nëse po, ndani shembujt për këto produkte:

MQ	Po, Departamenti për arsim dhe komunikim i Institutit Parlamentar ka përgatitur posterë edukues të gjuhës të shenjave dhe ka publikuar materiale arsimore (lista me fakte) të shkrimit braj dhe në formë audio. Në posterë përdoren foto dhe tekst të gjuhës të shenjave për të përshkruar këto nocione: Kuvendi (parlamenti), deputeti, kushtetuta, ligji, demokracia dhe zgjedhjet.
BE	Jo
IZ	Parlamenti i Kneset (https://main.knesset.gov.il/EN) ka përdorur Udhërrëfyesin dhe Videon për qasshmërinë e parlamentit. Të njëjtat mund të shkarkohen në këto faqe të internetit: https://www.youtube.com/watch?v=3NEVD7rXhWw dhe https://main.knesset.gov.il/About/Documents/AccBookletEng.pdf
ÇE	Ende jo, nuk i përgatisim këto materiale
MB	Po, kemi. Kemi materiale të shkrimit braj. Verzionet në format lehtësisht të lexueshëm për kushtet e punës dhe Raporti për Komitetin për pyetjet e komitetit. Përpiqemi që ta bëjmë të lehtë për përdorim lexuesin e ekranit.
SLL	Në vitin 2010 është përgatitur numri i parë në broshurën e Kuvendit kombëtar të shkrimit braj në bashkëpunim me Shoqatën e personave të verbër dhe me shikim të dobët në Slloveni. Publikimi përshkruan historinë, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Kuvendit kombëtar. Përfshin edhe përshkrim të shkurtër të procedurës ligjore dhe aktiviteteve të trupave punuese. Më tutje, ndërtesa e parlamentit, historia e saj dhe karakteristikat arkitektonike të enterierit dhe eksterierit janë përshkruar në publikim. Në vitin 2011, Kushtetuta është publikuar dhe në shkrim Braj. Kështu, Kuvendi kombëtar ka treguar se qasja e barabartë në informata për personat e verbër dhe personat me shikim të dobët është një nga kushtet themelore për realizimin e të drejtës të garantuar kushtetuese të informatave, me çrast mundësohet pjesëmarrja në proceset demokratike dhe qytetarët aktiv.

Shtetet në pajtim me nenin 21, paragrafi 1 kanë detyrim që të ndërmarrin të gjithë masat përkatëse që të mundësojnë që personat me hendikep të mundin të realizojnë të drejtën e lirisë të shprehjes dhe mendimit, duke përfshirë edhe lirinë të kërkojnë, pranojnë dhe të japin informata dhe ide në bazë të barabartë me të tjerët përmes të gjithë formave të komunikimit të cilat do i zgjedhin vet. Si rregull e përgjithshme, gjithmonë duhet të jetë e mundur që të qasemi në informata duke përdorur

edhe format audio dhe vizuele. Nëse bëhen materiale apo sigurohen informata në formë audio – radio, televizion, fjalime të ndryshme – duhet të ketë ndonjë verzion vizuel, siç janë mbishkrimet apo procesverbalet. Nëse informatat janë në formë vizuele – postime në internet, shpallje në rrjetet sociale, video-duhet të ketë audio verzione, siç është podkasti.

Nëse Parlamentet duan që të përfaqësojnë interesat e qytetarëve të tyre dhe të pasqyrojnë shumëllojshmërinë e shoqërisë të tyre, atëherë të njëjtat duhet të marrin parasysh identitetin kulturor në secilin nivel të veprimit dhe në çdo veprim.

Parlamentet qasen ad hok në sigurimin e informatave të qasshme dhe të disponueshme për bashkësinë me hendikep. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar ka strategji për komunikim në të cilën janë përfshirë edhe personat me hendikep. Përmbajtjet e internetit, materialet promovuese, si dhe dokumentet janë të disponueshme për lexuesit e ekranit të Parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar. Parlamentet në përgjithësi nuk sigurojnë përshkrim audio të ngjarjeve dhe seancave.

Në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar, në PE, si dhe në Parlamentin e Izraelit, praktikë e mirë është se kanë forma video dhe audio si dhe pajisje që mund të ndihmojë për nevojat e personave me hendikep sensorik. Për dallim nga PE ku gjuha e shenjave nuk është inkorporuar në mënyrë sistematike në përdorimin e 24 gjuhëve, në Parlamentin e Mbretërisë të Bashkuar, gjuha britanike e shenjave është mundësuar në seancën për pyetjet e deputetëve në Dhomën e poshtme. Situata është e njëjtë edhe në Izrael ku zbatohet gjuha izraelite e shenjave.

2.4 Aktivitetet e përgjithshme dhe të veçanta

Qasja e parlamenteve në pyetjen se si të qasen në organizimin e ngjarjeve dhe nëse ka ngjarje të veçanta apo të përgjithshme me të cilat do të përfshiheshin edhe personat me pamundësi, varet nga qasjet dhe vështirësitë e institucioneve ndaj çështjes të hendikepit. Më së shpeshti institucionet qasen ndaj ngjarjeve speciale në të cilat ekskluzivisht thirren personat me pamundësi të njëjtë apo të ngjajshme. Në këtë kontekst edhe në pyetjen (Shihni: Tabelën P4), nëse parlamenti i juaj organizon dhe realizon aktivitete apo projekte të destinuara për personat me hendikep apo ato marrin pjesë në aktivitetet e rregullta të organizuara nga parlamenti i juaj, përgjigjet janë të ngjajshme. Pothuajse të gjithë parlamentet organizojnë ngjarje të përgjithshme dhe të veçante të përshtaturore për personat me hendikep, në pajtim me programet të cilat i kanë.

GPNP në bashkëpunim me Polio Plus në parlamentin maqedonas dhe në publik, ngjarjet i organizojnë për të gjithë qytetarët përfaqësues të SHQ pa dallim nëse janë OPH apo jo, me çrast insistohet që çdo ngjarje të jetë e qasshme për personat me hendikep dhe e shoqëruar në gjuhën e shenjave. IP në parlamentin maqedonas organizon ngjarje të veçanta edukuese për personat e verbër dhe me shikim të dobët në bashkëpunim me Këshillin kombëtar të të verbërve dhe veçanërisht për personat që janë të shurdhër dhe me dëgjim të dëmtuar në bashkëpunim me Shoqatën kombëtare të personave të shurdhër dhe me dëgjim të dëmtuar. PE nuk organizon ngjarje të veçanta vetëm për personat me hendikep. Parlamenti izraelit krahas ngjarjeve të rregullta organizon edhe ngjarje speciale apo vizita vetëm për personat me hendikep. Parlamenti Çek thekson se si të tjerët edhe personat me hendikep kanë mundësi që të marrin pjesë në ekskurzione, simulime, seminare edukuese në Dhomën e poshtme të deputetëve kur organizojnë ngjarje të tilla. Parlamenti slloven në ditën e "Ditëve të hapura të Parlamentit" tregon se mund të marrin pjesë edhe personat me hendikep. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar organizon edhe vizita të veçanta dhe të përgjithshme të personave me hendikep. (Shihni: Tabelën P4.1)

P 4. A organizon dhe realizon parlamenti i juaj aktivitete apo projekte të destinuar në mënyrë speciale për personat me hendikep apo ata marrin pjesë në aktivitetet e rregullta nga parlamenti i juaj? Ju lutemi, merrni parasysh se jemi të interesuar për aktivitete apo projekte të cilat janë jashtë nga procesi formal i miratimit të ligjeve dhe i referohen fushës të arsimit politik apo aktiviteteve të destinuar për hapjen dhe afri-min e parlamentit deri te këto grupe të njerëzve (për shembull, organizimi e tavolinave të rrumbullakta, seminarët e specializuara, vizitat për udhëheqje etj.).

MQ	GPNP organizojnë disa tryeza të rrumbullakta dhe debate publike në vitet e fundit të cilat përfshijnë tema për të drejtat, përfshirjen dhe pjesëmarrjen politike për personat me hendikep. Krahas asaj, IP organizonte dy tryeza të rrumbullakta në bashkëpunim me shoqatat e të verbërve dhe personat me shikim të dëmtuar dhe me shoqatën kombëtare të të shurdhërve dhe personave me vështirësi në dëgjim.
BE	Parlamenti europian ka spektër të gjërë të vizitorëve në lokacionet e tyre kryesore të punës, Strazburg, Bruksel, Luksemburg, si dhe në vendet anëtare të BE-së. Disponueshmëria e ofertës varion sipas lokacion. Vizitat e lokacioneve të ndryshme nuk janë specifikisht të organizuara për personat me hendikep, por shërbimet mund të përshtaten për secilin vizitor me hendikep që të integrohen në tërësi.
IZ	Po, Kneset organizon dhe realizon aktivitete të rregullta dhe të destinuar në mënyrë speciale për personat me hendikep. Të gjithë vizitat me udhërrëfyes janë të disponueshme për personat me hendikep. Të gjithë seancat edukuese për rolin e Knesetit dhe anëtarët e tij janë të disponueshme dhe të qasshme. Gjithashtu, ekzistojnë vizita për pjesëmarrësit me hendikep. Vizitorët mund të kërkojnë ndihmë nga shërbimet në Kneset dhe në udhërrëfyesit turistik. Qendra për vizitorë e Knesetit siguron pajisje të ndryshme si dhe dëgjuese për përforcimin e zërit për personat me dëgjim të dëmtuar. Nga personat me hendikep të cilëve u nevojitet përshtatje e caktuar përkatëse për ndonjë vizitorë apo gjatë vizitës të Knesetit, kërkohet prej tyre të dërgojnë kërkesë në Qendrën për vizitorë të Knesetit të paktën një javë para vizitës të tyre.
ÇE	Personat me hendikep kanë mundësinë që të marrin pjesë në ekskurzione, simulime, seminare edukative në Dhomën e poshtme të deputetëve.
MB	Pak nga të dyja, disa janë përshtatur, disa janë të zakonshme.
SLL	Ditë të hapura

Ngjarjen “Dita europiane për të rinj” përpiqemi që ta bëjmë sa më përfshirëse që është e mundur. Ngjarja organizohet në çdo vit në selinë e Parlamentit, në Strazburg dhe grumbullon më shumë se 8.000 persona të rinj nga e gjithë Europa që të diskutojnë për idetë e tyre për të ardhmen e Europës. PE në organizim të ngjarjes “Dita europiane për të rinj” përfshin Forumin europian për hendikep dhe nga kjo pozitë ata nuk këshillojnë dhe nuk japin mbështetje gjatë komunikimit dhe organizimit me personat me hendikep. Përpjekjet në Parlamentarium në Bruksel, Qendra për vizitorë e PE-së dhe “Përvojat e Europës” (Përvojat e BE-së) në vendet anëtare u ofrojnë përvojë individuale përmes stacioneve mediatike të cilat janë të disponueshme për të gjithë vizitorët, pa dallim nëse janë me hendikep apo jo. Qëllimi është që të gjithë elementet dhe mjetet të jenë të disponueshme për personat me pamundësi pa patur nevojën e përshtatjeve të veçanta apo modifikimeve, as mbështetjes nga personat tjerë. Në atë drejtim kemi bërë dizajnin që është më së shumti ergonomik, me përkthim dhe sinkronizim, nivelet minimale të kontrastit për lexueshmëri etj., të cilat do të mund të shfrytëzojnë vizitorët me hendikep. Më saktësisht, PE-ja dhe Përvojat e Europës insistojnë që të bëjnë të gjithë stacionet mediatike të qasshme dhe disponueshme, shumica e përmbajtjeve të videove janë me titra në gjuhën lokale dhe në gjuhën angleze dhe në të gjithë 24 gjuhët zyrtare të BE-së. Për më tepër, përmbajtja e caktuar është e disponueshme në 8 gjuhë të shenjave në Parlamentarium në Bruksel (gjuhën ndërkombëtare të shenjave dhe gjuhën belge të shenjave) dhe pothuajse e gjithë përmbajtja është me titra në 24 gjuhë. (Përgjigje e PE-së për pyetjen P4.1)

P 4.1. A ofroni ju aktivitete të veçanta të destinuara për personat me lloje të ndryshme të hendikepit (verbëri, shurdhëri, hendikep fizik, etj) Apo aktivitete të përgjithshme të destinuara për personat me të gjithë llojet e hendikepit?

MQ	Deri tani, Instituti parlamentar organizon aktivitete të ndara të destinuara për personat me lloj të ndryshme të hendikepit.
BE	Me qëllim që të rritet integrimi i të gjithë vizitorëve, oferta për vizita e personave të cilët shfrytëzojnë ndihmëse është përshtatur për personat me lloj të ndryshme të hendikepit. Ne pranojmë çfarëdo lloj grupe, nënkuptohet edhe grupet me anëtarë që kanë hendikep. Në rast se ftohen si grup i sponsorizuar, PE-ja ofron kontribut financiar shtesë për mbulimin e nevojave të tyre në lidhje me hendikepin e tyre – udhëtime, akomodim, interpretues në gjuhën e shenjave, etj. Gjithashtu, zakonisht kemi vizitorë individual me ndonjë lloj të hendikepit (persona me shikim të dëmtuar, persona me dëgjim të dëmtuar, hendikep fizik). Në Strazburg, me kërkesë, mund të organizohen vizita individuale.
IZ	Vizita organizohet sipas nevojave të grupit.
ÇE	Po, kemi krijuar një projekt. Ky është simulim i projekt-ligjit, në të cilin morën pjesë edhe studentë me “vëmendje të çrregulluar”.
MB	Po, ne, kemi vizita për vizitorët e verbër dhe me shikim të dobët, sigurojmë interpretues në gjuhën angleze të shenjave dhe opsioni i zhvilluar në mënyrë të pavarur për gjuhën britanike të shenjave apo titrave. Kemi toalet të qasshëm, pa shkallë.
SLL	Qasja për personat me hendikep: Kemi qasje të siguruar për personat të cilët shfrytëzojnë karrocë (ashensorë, rampa, rampa të lëvizshme, toalete të qasshme...). ekzistojnë katër ashensorë me platformë për karrocën për invalid të lokalizuar në vende të ndryshme. Salla e madhe e Kuvendit kombëtar siguron qasje në foltore për personat me hendikep të cilët shfrytëzojnë karrocë. Ka vende të rezervuara për personat me hendikep në Sallën e madhe, në ballkonin e Sallës të madhe. Kuvendi kombëtar ka parking personal. Personat e verbër mund të hyjnë në Kuvendin kombëtar së bashku me qentë e tyre udhërrëfyes. Pajisja teknike për personat me dëgjim të dëmtuar është instaluar në ballkonin e Shtëpisë të madhe të Kuvendit kombëtar dhe u mundëson që të dëgjojnë seancën. Në Sallën e madhe dhe në të gjithë hapësirat për takime të Kuvendit kombëtar ka dhe sistem FM me transmetues dhe katër pranues pa rrjet, të cilët funksionojnë vetëm kur sistemi i konferencës është përfshirë në hapësirën e caktuar për takime. Nga dhjetori i vitit 2009, në Kuvendin kombëtar është instaluar pajisja teknike për dëgjim e cila u mundëson personave me dëgjim të dëmtuar që të ndjekin seancat dhe ngjarjet nga ballkoni në Sallën e madhe me ndihmën e ndihmëses universale për dëgjim. Gjithashtu, janë siguruar kushte të barabarta për personat me dëgjim të dëmtuar në të gjithë hapësirat për takime në Kuvendin kombëtar. Nga viti 2002, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhës sllovene të shenjave dhe pas marrëveshjes paraprake, Kuvendi kombëtar ka siguruar interpretimin në gjuhën sllovene të shenjave për të gjithë të ftuarit të trupave punuese apo ngjarjeve tjera.

Sa i përket praktikave (Shih: Tabelën P 4.2), Parlamenti europian dhe Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar theksojnë se është shumë e rëndësishme përfshirja dhe bashkëpunimi me personat me hendikep. Të njëjtët theksojnë se i gjithë personeli që punon me vizitorët paraprakisht ka kaluar trajnimin për qasje dhe komunikim me personat me hendikep. Parlamenti çek thekson se organizimi i ngjarjeve të cilat duhet të jenë të qasshme kërkon më shumë kohë dhe në pyetësorë theksojnë se “Është mirë të rezervoni më shumë kohë për këto aktivitete. Kjo është përvojë e mirë për ne dhe në bazë të saj përpiqemi që të përmirësojmë”.

P 4.2. A mundeni që shkurtimisht të shpjegoni disa nga praktikat e mira për organizimin dhe zbatimin aktiviteteve/projekteve të tilla?

MQ	Anëtarët e GPNP dhe Ambasada e Mbretërisë të Bashkuar kanë bërë videomaterial në formë të dokumentarit "Një ditë në jetë", me mbështetje të Fondacionit të Uestminster për demokraci, në të cilin deputetët dhe personat me aftësi të kufizuara kalojnë një ditë bashkarisht. Ky videomaterial ka kontribuar për ngritjen e vetëdijes për të drejtat dhe nevojat e personave me hendikep në vendin tonë. Më tutje, GPNP së bashku me organizatën Polio Plus – Lëvizja kundër hendikepit inicoi Deklaratën për të drejtat e pjesëmarrjes politike të personave me aftësi të kufizuara, që është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në dhjetor të vitit 2019.
BE	Në sektorin "Vizita dhe seminare", organizohen trajnimet specifike për përmirësimin e mënyrës të përafimit të personave me lloje të ndryshme të hendikepit. Këto trajnime specifike janë të orientuara drejtë të gjithë personelit që mund të ketë kontakt me vizitorët: ekipi për siguri, udhërrëfyesit për praninë dhe të ngjajshme. Për ekspozitat "Parlamentarium në Bruksel" dhe "Përvoja në Europë, konsiderojmë se është shumë e dobishme që të përfshihen personat me hendikep për testimin e përmbajtjes të ekspozuar. Inkurajojmë vizitorët me hendikep që të japin informacione kthyesë të detajuara për përvojën e tyre, duke përfshirë edhe kolegët nga grupi jonë për mbështetje të personave me hendikep, të cilët disa herë na kanë vizituar disa herë kanë informacione kthyesë dhe propozime për përmirësim. Përfshirja e konsulentëve për qasshmëri, në formë të revizioneve për qasshmëri në bazë të planeve të arkitektit, është e dobishme gjatë kohës të procesit të dizajnit në pajtim me praktikën më të mira, për përmbajtjet e reja apo hapësira për vizitorët të cilat i hapim. Në Strazburg, ofrojmë vizita në pajtim me nevojat; programi dhe vazhdimësia janë të përshatuar dhe të vendosura në bashkëpunim me shërbimet tjera (SAFE, INLO) me qëllim që të përshtaten për vizitorët me gjendje të ndryshme të hendikepit.
IZ	Përvojë speciale demoraktive për grupet e personave me hendikep është vizita e cila është e përshtatur me nevojat e këtij grupi. Struktura dhe përmbajtja e vizitës është përshtatur me nevojat e grupit. Kjo vizitë ofrohet në gjuhën hebraike dhe arabe, dhe nëse është e nevojshme edhe në gjuhën e shenjave.
ÇE	Mirë është të rezervohet më shumë kohë për këto aktivitete. Kjo është përvojë e mirë për ne dhe në bazë të saj përipiqemi që të përmirësohemi.
MB	I gjithë personeli është i trajnuar, kemi ekip të centralizuar për shumëllojshmëri dhe përfshirje që ndihmon që të koordinohen këto projekte. Ekipi jonë për shërbime për vizitorë ka caktuar Udhërrëfyes për përfshirje dhe shumëllojshmëri.
SLL	Nuk ka informata

Në aspekt të organizimit të vizitave për vizitorët e parlamentit, praktika është e ndryshme. Disa parlamente organizojnë vizita të veçanta speciale të parlamenteve për personat me hendikep, kurse disa i përfshijnë dhe inkurajojnë personat me hendikep që të përfshihen në vizitat e rregullta. Kështu (Shihni: Tabelën P 4.3) PE nuk ka vizita të veçanta speciale për vizitë të PE-së për personat me hendikep, por oferta e tyre e përgjithshme për vizita i referohet personave me hendikep. Parlamenti maqedonas nuk ka procedurë të përcaktuar, e kështu nëse kushtet lejojnë, personat me hendikep janë të përfshirë në vizitat e rregullta me udhërrëfyes, por në raste tjera organizohen vizita të veçanta dhe të specializuara me udhërrëfyes për grupin e caktuar të synuar me hendikep. Parlamenti izraelit thekson se të gjithë vizitat janë të qasshme dhe të disponueshme për personat me hendikep dhe të njëjtat mund të përfshihen në vizitat e rregullta të vizitës të parlamentit, diku siguruar një spektër të gjërë të përshtatjeve përkatëse. Parlamenti slloven thekson se nuk ka vizita të veçanta por në vizitat e rregullta të Parlamentit, janë përfshirë edhe personat me hendikep. Parlamenti i Çekisë siguron qasje individuale, me çrast vizitat janë të destinuar për publikun më të gjërë, por edhe për personat me hendikep, gjithashtu sigurojnë edhe ekskurziona vetëm për personat me hendikep. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar thekson se organizon edhe vizita të veçanta speciale vetëm për personat me pamundësi të ndryshme.

P 4.3. A ofroni vizita të specializuara me udhërrëfyes për personat me hendikep apo këto persona janë përfshirë në vizitat e rregullta të cilat i organizon parlamenti i juaj?

MQ	Nuk ka procedurë të përcaktuara. Në disa raste, nëse kushtet lejojnë, personat me hendikep janë të përfshirë në vizitat e rregullta me udhërrëfyes, kurse në rastet tjera organizohen edhe vizita të veçanta dhe të specializuara me udhërrëfyes për grupin e caktuar të synuar të personave me hendikep.
BE	Ata janë përfshirë në ofertën tonë të përgjithshme për vizita të personave me hendikep në Bruksel, por është e dukshme se ne u kushtojmë vëmendje të veçantë kur situata e kërkon një gjë të tillë. Vizitorët mund të qasen në përmbajtje në 24 gjuhë përmes përdorimit të udhërrëfyesve mediatic (pajisje të modifikuara iPod). Mes mundësive të disponueshme, opsioni për gjuhë ka tetë gjuhë të shenjave. Vizitorët e verbër dhe me shikim të dobët mund të zgjedhin udhërrëfyesin mediatic në katër gjuhë. Për to ka edhe audiovizitë e cila aktivizohet sipas lokacionit; vizita e shpjegon orarin hapësinor të qendrës tonë për vizitorë, si dhe përmbajtjen që është e disponueshme në çdo pjesë. Në Strazburg, personat me hendikep janë përfshirë në vizitat e rregullta me udhërrëfyes.
IZ	Të gjithë vizitat me udhërrëfyes janë të disponueshme për personat me hendikep. Kjo ndoshta do të thotë se personat me hendikep mund të marrin pjesë në vizitat e rregullta me të gjithë mbështetjen nga Kneset (skuter për lëvizjen elektrike, qentë udhërrëfyes, karrocet invalide dhe ashensorët, vendet e disponueshme për pushim, ndihmëset, siç janë sistemet e dëgjimit, vizitorët, gjithashtu, mund të kërkojnë përshtatje speciale, siç janë përkthimi në gjuhën e shenjave apo shkresa).
ÇE	Ne ofrojmë qasje individuale. Vizitat janë destinuar për publikun më të gjërë dhe për personat me hendikep apo ofrojmë ekskurzime vetëm për personat me hendikep.
MB	Kemi vizita speciale për llojet e caktuara të hendikepit.
SLL	Janë përfshirë në vizitat e rregullta të organizuara nga parlamenti.

Vizitat e veçanta dhe speciale gjithsesi se imponojnë pyetjen edhe për trajnimin e udhërrëfyesve special dhe kuratorëve për organizimin e vizitave në parlament. Në mënyrë analogjike edhe me përgjigjet nga pyetjet P 4.2 dhe P 4.3, parlamentet kanë përvoja të ndryshme (Shihni: Tabelën P 4.4). Parlamenti maqedonas thekson se nuk ka trajnim të veçantë paraprak për udhërrëfyesit për vizitat e specializuara për personat me hendikep. PE thekson se i gjithë personeli është trajnuar për qasje dhe komunikim me personat me hendikep. Në Mbretërinë e Bashkuar udhërrëfyesit janë trajnuar për qasje dhe komunikim me personat me hendikep, por edhe se kanë udhërrëfyes të specializuar për gjendjet e caktuara të pamundësisë. Në Izrael, të gjithë personat e punësuar në shërbime kanë për detyrë të fitojnë aftësi për këtë çështje, por edhe udhërrëfyesit kanë trajnimet e specializuara.

Koncepti i dytë kryesorë për realizimin e të drejtës të qasshmërisë në pajtim me Konventën është "përshtatja e duhur". Ky koncept bazohet në qasjen dhe kërkimin individual, për të cilin duhet të gjejnë kompromis të përbashkët të dy palët në realizimin e të drejtave të personit me hendikep. Në këtë drejtim edhe parlamenti krahas zbatimit të qasshmërisë universale dhe disponueshmërisë të cilën duhet ta kenë prej në fillim, duke patur parasysh gjendjet e ndryshme të pamundësisë duhet të mundësojnë dhe ofrojnë përshtatje të duhur për personat me hendikep. Në këtë kontekst (Shihni Tabelën P 4.5) PE, Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar dhe Parlamenti i Izraelit, parlamentet tjera nuk sigurojnë dhe nuk ofrojnë përshtatje të duhur për personat me hendikep.

Në rast se kanë nevojë për mbështetje të veçantë mund të dërgojnë e-porosi duke shpjeguar për nevojat e tyre. Krahas kësaj, një numër i kufizuar i karrocave janë të disponueshme për vizitorët në hyrje. Gjithmonë kur komunikojmë për ofertën për vizitorë, gjithmonë e përmendim qasshmërinë për personat me hendikep fizik dhe nëse oferta është përshtatur edhe për vizitorët me shikim apo dëgjim të dëmtuar. (Përgjigje nga PE në pyetjen P 4.4.). Në Strazburg, gjatë rezervimit të ueb-faqes, vizitorët kanë mundësinë të kërkojnë ndihmë speciale paraprakisht, përmes e-porosisë (karroca, sigurim të qasjes deri në hyrje). Nuk mund të garantojmë interpretim në gjuhën e shenjave (përgjigje nga PE në pyetjen P 4.4)

P 4.4. Nëse ofroni vizita të specializuara, a e bëjnë këtë udhërrëfyesit e rregullt për vizita dhe nëse pjesëmarrësit marrin pjesë në trajnim të specilizuar për punë me personat me hendikep?

MQ	Vizitat e specializuara kryhen nga udhërrëfyesit e rregullt pa trajnim për punë me persona me hendikep.
BE	Siç është shpjeguar në P 2, për vizitat e personave të cilët shfrytëzojnë ndihmë në departamentin në Bruksel përgatiten seanca specifike për trajnim për të gjithë personelin që mund të ketë kontakt me vizitorët. Në rast se kanë nevojë për mbështetje të veçantë mund të dërgojnë e-porosi me shpjegimin e nevojave të tyre. Krahas kësaj, numër i kufizuar i karrocave janë të disponueshme për vizitorët në hyrje. Ekspozitat e Planetariumit dhe Përvojat e Europës nuk ofrojnë vizita që janë përgjithësisht të disponueshme dhe ne nuk punësojmë udhërrëfyes. Kërkesat speciale parashtrihen në bazë ad hok deri te ekipi ynë. Në Strazburg, udhërrëfyesit tonë kanë punuar në zgjidhje dhe propozime të ndryshme me qëllim që t'u ofrojnë përvojë më të mirë vizitorëve me hendikep. Krahas kësaj, ata kanë krijuar udhëzime për përfshirjen e mjeteve të reja për komunikim me një fjalor të përshtatur dhe të personalizuar të drejtuar drejtë personave me aftësi të kufizuara intelektuale.
IZ	Me shumë gjasa, udhërrëfyesit e vizitave kanë marrë pjesë në trajnimin special për punë me grupe specifike të synuara
ÇE	Nuk kemi udhërrëfyes të veçantë. Kemi vetëm udhërrëfyes të rregullt.
MB	Udhërrëfyesit e vizitave të rregullta janë trajnuar dhe kemi udhërrëfyes të specializuar të vizitave për grupet të cilat dallohen nga vizitat tjera (për shembull, për ata me sindromin e Tourettit).
SLL	Nuk ka informata

P 4.5. Nëse ofrohen vizita në ndërtesën e parlamentit, a janë të njoftuar vizitorët se mund të kërkojnë dhe të marrin përshtatje përkatëse, siç është interpretuesi i gjuhës të shenjave?

MQ	Grupet zakonisht vijnë me përkthyesin e tyre në gjuhën e shenjave.
BE	Informata për qasshmëri janë të disponueshme në ueb-faqen tonë për çdo lokacion. Personeli jonë është trajnuar për vizitorët me hendikep dhe është i përgatitur që të ofrojë kapacitetet e disponueshme për përshtatje. Gjatë kohës të vizitave të personave të cilët shfrytëzojnë ndihmë në Bruksel, të punësuarit bashkëpunojnë me interpretuesit në gjuhën e shenjave. Udhërrëfyesit e grupeve të vizitorëve i organizojnë shërbimet për këto interpretues.
IZ	Po
ÇE	Nuk ofrojmë këtë opsion
MB	Po
SLL	Nuk ka informatë

Zhvillimet e reja në botë me epideminë e KOVID 19 gjithsesi se kanë ndikimin e tyre mbi punën e parlamenteve. Riorganizimi i tyre pasqyrohet edhe mbi aktivitetet të cilat parlamentet i ndërmarrin edhe ndaj bashkësisë me hendikep. Një pjesë e madhe e përgjigjeve (Shihni: Tabelën 4.6) theksojnë se disa parlamente janë qasur drejtë përshtatjes të ofertave të tyre, përderisa një pjesë nuk kanë informata (Izrael, Slloveni). Parlamenti maqedonas përmes IP në peridhën e pandemisë ka organizuar vizita virtuale. PE thekson se masat e sigurisë nuk kanë ndikuar në mënyrë të konsideruar mbi qasshmërinë, por gjithsesi kanë bërë ndryshim të ofertës për vizitorët në pajtim me standardet e reja. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar në tërësi është ridrejtuar në komunikim përmes internetit, ndërsa parlamenti çek ka bërë ueb-faqe të re edukuese të cilën mund të shfrytëzojnë edhe personat me hendikep.

P 4.6. A ka bërë parlamenti i juaj ndonjë përshtatje gjatë kohës të periudhës të pandemisë Kovid -19? Nëse po, si kanë ndikuar këto përshtatje mbi aktivitetet e destinuar për personat me hendikep? Ju lutemi, theksoni përvojën apo praktikën e mirë, nëse është e mundur.

MQ	Duke marrë parasysh kufizimet për vizita të Kuvendit për shkak të gjendjes me pandeminë Kovid -19, instituti parlamentar ka vendosur që të fillojë praktikisht të kryejë aktivitetet e destinuar për promovimin e kulturës të të qenit të hapuar në organin ligjvënës. Në atë drejtim janë organizuar disa vizita virtuale në ndërtesën e Kuvendit, si dhe ueb-punëtori edukative të destinuar për grupet e ndryshme të synuara (nxënës dhe studentë). Nuk kemi informata nëse ka patur nxënës me hendikep. Në këtë periudhë nuk është ndërmarrë aktivitet i specializuar për personat me hendikep.
BE	Në përgjithësi duhej të bëheshin përshtatje për ofertën për vizitorë të Parlamentit e cila është në dispozicion që të sigurohet distanca fizike, të kufizohet numri i vizitorëve, të vendoset rrugë me një drejtim për lëvizje dhe të sigurohet se të gjithë hapësirat të cilat shpesh preken dezinfektohen apo nuk janë të disponueshme për vizitorët. Në Parlamentin e Brukselit, kjo do të thotë se 60% nga përmbajtja origjinale momentalisht është e disponueshme për vizitorët. Meqënëse udhërrëfyesi audio që është i disponueshëm për vizitorët me shikim të dëmtuar nuk është përditësuar me rrugën e re për lëvizje, tashmë nuk e ofojmë vizitorëve tonë. Në vend të kësaj, vizitorët me shikim të dëmtuar udhëhiqen nga një i punësuar gjatë kohës të vizitës të tyre. Qasshmëria fizike e ekspozitës nuk është prekur. Masat e sigurisë të zbatuar në ekspozitat "Përvojat e Europës" në shtetet anëtare nuk kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në disponueshmëri.
IZ	Nuk ka informata
ÇE	Po. Kemi krijuar ueb-faqe të re edukuese për publikun dhe shkollat, e cila ofron teste, video, fleta pune, prezantime. Këtë ueb-faqe edukuese për publikun mund ta përdorin edhe personat me hendikep.
MB	Po, tani kontaktojmë përmes internetit me organizatat dhe aktivitetet në terren të cilat kërkojnë realizimin e aktiviteteve në terren sepse vizitat janë anuluar deri në shtator të vitit 2020.
SLL	Nuk ka informata.

Parlamentet kanë qasje të ndryshme në aspekt të organizimit të ngjarjeve, të cilat janë të disponueshme për të gjithë me apo pa hendikep. Praktika e parlamenteve thekson se kur bëhet fjalë për organizimin e vizitave për vizitorët e parlamentit, të njëjtat qasen drejtë vizitave speciale të destinuar vetëm për personat me gjendje të caktuar të hendikepit por edhe vizita të rregullta në të cilat mund të përfshihen edhe personat me hendikep.

Ngjatë vizitave të rregullta me rëndësi është koncepti i përshtatjes përkatëse, që është organizuar mirë në Parlamentin e Izraelit. Gjithashtu, edhe Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar dhe PE-ja real-

izojnë trajnime për të gjithë ekipin dhe kanë udhërrëfyes të cilët janë të trajnuar për komunikim me personat me hendikep. Parlamentet në PE dhe Mbretërinë e Bashkuar theksojnë se është shumë e rëndësishme përfshirja dhe bashkëpunimi me personat me hendikep.

Në periudhën e pandemisë, një pjesë e madhe e parlamenteve janë qasur drejtë riorganizimit të aktiviteteve të tyre duke përfshirë edhe aktivitetet për personat me hendikep.

2.5 Krijimi i partneriteteve

Detyrimi të konsultojnë qytetarët me hendikep është një nga parimet e Konventës. Me nenin 3 dhe me neni 4 (paragrafi 3), nga shtetet kërkohet që të konsultohen dhe në mënyrë aktive të përfshijnë qytetarët me hendikep në përgatitjen e politikave dhe programeve, duke përfshirë edhe personat me hendikep përmes organizatave të tyre përfaqësuese.⁴⁴ Komiteti për KDPH thekson se ky konsultim dhe përfshirja aktive i referohet dhe përfshin “të gjithë spektrin e masave ligjore, administrative dhe masave tjera që mundën në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthortë të ndikojnë në të drejtat e qytetarëve me hendikep ”.⁴⁵

2.5.1 Bashkëpunimi me organizatat e personave me hendikep

Në aspekt të bashkëpunimit dhe konsultimeve (Shihni: Tabelën P 5) Parlamentet në këto 6 vende kanë vendosur bashkëpunim me organizata të ndryshme, organizatat shumësektoriale të personave me hendikep, si dhe organizatat për gjendjet e caktuara me hendikep, madje edhe organizatat e personave me sëmundje të caktuara.

Në këtë kontekst PE thekson se bashkëpunimi i tyre është drejtuar para së gjithash drejtë organizatave ombrellë, respektivisht organizatat nën ombrellën e Forumit European për çështjen e hendikepit, kurse për fushat e caktuara të veçanta me organizatat për gjendjen e caktuar. Kështu ata tregojnë se kur kanë përgatitur videot parazgjedhore të PE-së në gjuhën e shenjave kanë bashkëpunuar me Aleancën e të shurdhërve dhe me dëgjim të dëmtuar në nivel të BE-së. Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar thekson se gjatë bashkëpunimit përfshin numër të madh të organizatave dhe ministrive duke përfshirë edhe organizatat bamirëse nga sektori i tretë⁴⁶. Parlamenti maqedonas, respektivisht IP ka bashkëpunim me Polio Plus dhe Aleancën e të shurdhërve dhe personave me dëgjim të dëmtuar, përmend bashkëpunimin e ngushtë të personave me hendikep me Nënkomitetin për shërbime sociale dhe Departamentin për komunikim.

⁴⁴ Konventa për të drejtat e personave me hendikep, neni 4 dhe neni 33. E disponueshme në: < <http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf>>

⁴⁵ Komenti i përgjithshëm numër 7, paragrafi 42, Komiteti i KDPH, 2018, E disponueshme në <<https://www.ohchr.org/en/hrbodies/crpd/pages/gc.aspx>>.

⁴⁶ Në Organizatat nga sektori i tretë në Britaninë e Madhe bëjnë pjesë: Organizatat bamirëse, Organizatat vullnetare në bashkësi, Sipërmarrjet sociale dhe bashkëpunuese, tink tanket dhe institutet private hulumtuese (këtu nuk bëjnë pjesë universitetet dhe kolegjet), Disa organizata, siç janë organizatat për akomodim, të cilat janë jashtë mbështetjes të Qeverisë dhe konsiderohen si kuazi grupe të sektorit të tretë, edhe pse sigurojnë shërbime publike. Më shumë <http://toolkit.northernbridge.ac.uk/engagingwithpolicymakers/engagingwiththethirdsector/whatisthethirdsectorandwhatdoesitdo/>

P 5. Me cilët aktorë të jashtëm bashkëpunon parlamenti i juaj në lidhje me punën me personat me hendikep (ministri, institucione shtetërore, shoqata kombëtare të personave me hendikep, organizata qytetare, shkolla të specializuara, qendrat ditore etj.)?

MQ	Shoqatat e personave të verbër dhe personave me shikim të dëmtuar të cilët janë anëtarë të Shoqatës kombëtare, Shoqatës kombëtare të personave të shurdhër dhe me dëgjim të dëmtuar, Polio Plus, OSBE, Fondacioni i Uestminster për Demokraci.
BE	Në varësi, DG COMM bashkëpunon me organizatat-ombrellë europiane me invaliditet siç janë Forumi European për hendikep apo Unioni i personave të shurdhër. Në kuadër të prodhimit të verzionit 31 të gjuhës të shenjave të filmit për fushatën parazgjedhore të Parlamentit European, DG COMM bashkëpunonte me Unionin European të të shurdhërve (UESH). Ata ndihmuan në përkthim, dhe, gjithashtu, dhe në cilësinë e kontrollit, UESH, gjithashtu promovonte videot dhe fushatën zgjedhore përmes anëtarëve të tyre të organizatës në të gjithë Europën.
IZ	Nuk ka informata
ÇE	Nënkomiteti për shërbime sociale dhe persona me hendikep, Departamenti për komunikim dhe arsim ofrojnë shërbim për personat me hendikep si pjesë e aktiviteteve të tyre.
MB	Të gjitha të numëruara në pyetje, duke përfshirë edhe organizatat bamirëse.
SLL	Nuk ka informata

Në pyetjen nëse ky konsultim dhe bashkëpunim është në vazhdimësi respektivisht nëse parlamenti ka praktikë që rregullisht të konsultohet me organizatat e personave me hendikep për pyetjet dhe aktivitetet e ndryshme të ndërmarra nga parlamenti apo shërbimi i kuvendit (Shihni: Tabelën 5.1) përgjigjja të të gjithë parlamentet është identike.

Më shpesh parlamentet në mënyrë ad hok vendosin bashkëpunim të caktuar dhe konsultohen me OPH për çështjet e caktuara. Në parlamentin maqedonas këtë vazhdimësi e mban GPNP të cilët bashkarisht me Polio Plus inicojnë aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë Kuvendit, për pyetje të ndryshme dhe tema të ndryshme. Bashkarisht organizojnë vizita dhe ngjarje për ngritjen e vetëdijes publike për njohjen e të drejtave individuale dhe kolektive të bashkësisë me hendikep. Ngjajshëm edhe te Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar, që mban ngjarje për bashkësitë me hendikep dhe i viziton organizatat sektoriale nga sektori i tretë dhe shkolla në bashkësi.

P 5.1 A ka parlamenti juaj praktikë që rregullisht të konsultohet me organizatat e personave me hendikep për çështje dhe aktivitete të ndryshme të ndërmarra nga parlamenti apo shërbimi i kuvendit (politika, dokumenta, aktivitetet edukuese dhe informative, etj). Nëse përgjigja është po, ju lutemi, shpjegoni shkurtimisht si realizohet ky bashkëpunim

MQ	Aktivitetet e tilla në përgjithësi i merr GPNP bashkarisht me Polio Plus.
BE	Nuk ka informata
IZ	Nuk ka informata
ÇE	Nuk kemi përvojë në komunikim të rregullt me organizatat e personave me hendikep për çështjet dhe aktivitetet e ndryshme të ndërmarra nga parlamenti apo shërbimi i kuvendit.

MB	Ne kontaktojmë, inkurajojmë grupet të na vizitojnë dhe të përfshihen në punë nga jashtë, duke inkurajuar që të ndajnë përvojat, siç janë transporti publik. Mbajmë ngjarje me bashkësitë me hendikep dhe shkojmë në vendin e ngjarjes që të vizitojmë organizatat sektoriale dhe shkollat në bashkësi që të mundësojmë të përfshihen në parlamentin e tyre.
SLL	Nuk ka informata


Duke patur parasysh sa heterogjene është bashkësia me hendikep, qasja me mëshirë dhe mjekësore kanë shkaktuar formimin e ofruesve të ndryshëm të shërbimeve për gjendjet e caktuara, organizatat e prindërve për diagnozat e caktuara, organizatat për vetëpërfaqësim, organizatat e personave me diagnoza të caktuara, kurse ekzistojnë edhe “organizata-ombrellë” të cilat më së shpeshti, nën kujdesin e shteteve dhe bashkë me institucionet, promovojnë qasjen mjekësore dhe me mëshirë ndaj bashkësisë me hendikep, por ekzistojnë edhe organizata shumësektoriale të personave me hendikep të cilat punojnë me të gjithë gjendjet me hendikep, në pajtim me nenin 1 nga Konventa. Në atë kontekst, në çdo vend, madje edhe në ata 6 Parlamente të intervistuar ekziston shumëllojshmëri e madhe në lëvizjen e personave me hendikep. Meqënëse ka spektër të gjërë të gjendjeve me hendikep, është thelbësore që Parlamentet të bashkëpunojnë me organizatat shumë-sektoriale apo në koalicion me organizatat e personave me hendikep, të cilat kanë njohje gjithëpërfshirëse të detyrimeve nga Konventa. Shpesh empatia në realizimin e aktiviteteve kur bëhet fjalë për persona me hendikep shkon deri në atë shkallë që në vend të të drejtave të njeriut promovon mëshirë që në asnjë rast nuk shpie në inkurajimin e bashkësisë me hendikep për përfshirje aktive dhe përfaqësim për të drejtat e tyre dhe është në kundërshtim me detyrimet nga Konventa.

Në çdo rast, vendosja e bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm me shoqërinë civile, respektivisht OPH nga njëra anë është detyrim për Parlamentin, por nga ana tjetër bashkëpunimi me OPH mund të sjellë dhe përfshijë inovacionin e ekspertëve dhe praktikë në punën e deputetëve, por edhe vetë shërbimeve në Parlament. OPH të cilat fokusohen në tema për të drejtat e njeriut në pajtim me Konventën shpeshherë mund të jenë burim i ekspertizës për nenet e caktuara në Parlament të cilat dëshirojnë që të rrisin njohurinë e tyre për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Për ekspozitat e “Planeteriumit në Bruksel” dhe “Përvojës në Europë”, konsideruam se është shumë e dobishme që të përfshihen personat me hendikep me testimin e përmbajtjes të ekspozuar që të sigurohet se supozimet tona origjinale janë të sakta. Nga ana tjetër, ftojme vizitorët me hendikep të lënë informata të hollësishme kthyesë për përvojën e tyre, duke përfshirë edhe për kolegët nga grupi jonë për mbështetje të hendikepit, të cilët disa herë na kanë vizituar dhe kanë lënë informata të vlefshme kthyesë dhe propozime për përmirësim. Nga ana tjetër, kemi zbuluar se përfshirja e konsulentëve për qasshmëri në formë të revizioneve për qasshmëri në bazë të planeve të arkitektit, është e dobishme që gjatë kohës të procesit të dizajnit që të sigurohemi se jemi në pajtim me praktikat më të mira për përmbajtjen e re apo hapësirat për vizitorët të cilat i hapim. (Përgjigje e PE-së në pyejtjen P 4.2)

Sipas përvojës të kolegëve tonë të cilat organizojnë ngjarje dhe fushata, ndoshta më e rëndësishme është që të përfshini personat me hendikep dhe organizatat e personave me hendikep në planifikimin dhe dizajnimin e aktiviteteve të juaja me qëllim që të jenë më të vërtetë inkluzive (përfshirëse). Puna e dytë e rëndësishme është të thuhet shumë qartë gjatë komunikimit tuaj se pjesëmarrja e personave me hendikep është e mirëseardhur, madje edhe e inkurajuar. Se mbështetja që planifikoni ta jepni ndoshta nuk është e përkryer, por se do të përpiqeni të jepni gjithçka nga vetja që të mbulonin nevojat e tyre dhe t’u ndihmoni që të kenë përvojën më të mirë të mundur. (Përgjigje e PE-së në pyetjen P 4.2)

Bashkëpunimi dhe përfshirja e personave me hendikep gjatë krijimit dhe realizimit të aktiviteteve nga ana e Parlamentit është shumë e rëndësishme për të siguruar barazinë inkluzive, por edhe sigurimin e përfaqësimit adekuat për personat me hendikep. Praktika Bashkëpunimi dhe përfshirja e personave me hendikep gjatë krijimit dhe realizimit të aktiviteteve nga ana e Parlamentit është shumë e rëndësishme për të siguruar barazinë inkluzive, por edhe sigurimin e përfaqësimit adekuat për personat me hendikep. Praktika e këtyre gjashtë parlamenteve thekson se më së shpeshti të njëjtët përkohësisht qasen drejtë personave me hendikep apo organizatave të tyre përfaqësuese në realizimin e aktiviteteve të caktuara.



KAPITULLI 3.

Hapat të cilat duhet të ndërmerren

Duke patur parasysh se pyetësi i strukturuar i referohet më së shumti parlamenteve dhe hapat e tyre të cilat i ndërmarrin në aspekt të zbatimit të një pjesë të detyrimeve nga Konventa, në këtë kapitull do të prezantohen hapat të cilat duhet të ndërmerren në nivel të parlamentit, por edhe hapa të cilat mund të ndërmerren nga ana e IP.

3.1 Rekomandimet e Parlamentit drejtë zbatimit të Konventës

- Edhe pse Konventa nuk krijon rregulla të reja, megjithatë me natyrën e tyre programuese dhe përmes përshkrimit të politikave të cilat shtetet duhet të ndërmarrin, Konventa është instrumenti më i rëndësishëm juridik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave me hendikep. Këto të drejta domosdoshmërisht duhet të integrohen edhe në Parlament.
- Nevojitet përgatitja e analizës gjithëpërfshirëse të politikave të parlamentit maqedonas nga aspekti i pamundësisë. Kuvendi meqënëse nuk ka përgatitur këtë lloj të analizës të detajuar duhet ta bëjë atë me qëllim të zbatimit të detyrimeve të cilat rrjedhin nga Konventa.
- Kuvendi duhet të përgatis planin e veprimit për avancimin e qasshmërisë, si nga aspekti i qasshmërisë fizike, ashtu edhe aspekti i qasshmërisë informatike dhe të komunikimit në dhe deri në parlament, me tregues dhe mekanizma në atë plan. Paralelisht në Kuvend duhet të përgatisë Udhërrëfyesin për zbatimin e institutit juridik për përshtatjen përkatëse, si dhe të sigurojë mjete financiare për zbatimin e tij.
- Mospasja e statistikave, por edhe vetë rezistenca nga ana e personave që të identifikohen si persona me hendikep është edhe një indicje se vlerat ekzistuese nuk janë në frymën e Konventës. Në atë drejtim në statistikën e parlamentit për kapitalin njerëzor, krahas aspektit gjinor dhe përfaqësisë etnike, është e domosdoshme që të inkorporohen edhe evidenca për gjendjen e hendikepit në pajtim me nenin 31 të Konventës.
- Parlamentet kombëtare gjithnjë e më shumë ndërmarrin hapa që të sigurohet shumëllojshmëri në përbërjen e tyre, duke përfshirë gratë, pakicat etnike. Nga gjashtë parlamentet në hulumtim, vetëm Parlament në Mbretërinë e Bashkuar thekson për ekzistimin e sistemit të kuotave për përfshirjen e personave me hendikep në shërbimet e Parlamentit.
- Njëkohësisht përmes mekanizmit të praktikës, parlamentet mundësojnë përfshirjen e personave me hendikep. Në atë drejtim, parlamenti maqedonas duhet të përfshijë edhe masa të reja që të bëhet jeta politike më tërheqëse për bashkësinë me hendikep (për shembull, kuotat për punësim të personave me hendikep në shërbimet e parlamentit) apo të miratohen masat për punë praktike dhe stazh të burrave dhe grave me hendikep në shërbimet e ndryshme në parlament.
- Duke patur parasysh gjithëpërfshirjen dhe fushëveprimin më të madh të Konventës, Kuvendi duhet të fus detyrimin që çdo trup punues të inkorporojë çështjen e hendikepit, përmes përgatitjes të detyrueshme të planit të veprimit dhe zbatimit të Konventës, sipas shembullit të PE-së.
- GPNP si grup joformal duhet të formalizohet në kuadër të Kuvendit dhe të bëhet pjesë e trupave punuese dhe si trup joformal i kuvendit do të ketë mandat që të shqyrtojë të gjithë ligjet dhe të jap rekomandime për harmonizimin e tyre me Konventën, si dhe zbatimin e mbikqyrjes.
- Duke e ndjekur praktikën e mirë në Parlamentin e Izraelit, rekomandohet që kuvendi maqedonas në nivel të udhëheqësve të lartë të shërbimit të angazhojë dhe përfshijë persona, rekomandohet të jetë me person me hendikep që kjo të mundësojë ndjekjen parlamentare dhe avancimin e qasshmërisë në Kuvend.

3.2 Rekomandimet për IP drejtë zbatimit të Konventës

- IP në kuadër të fushëveprimit të tij të punës dhe Strategjisë të miratuar, është e domosdoshme të qaset drejtë revizionit të tyre dhe në të njëjtën të inkorporohet çështja e pamundësisë, në të cilat do të parashihen tregues konkret dhe mekanizma për ndjekje.
- IP mundet që në fushëveprimin e tij të përgatisë udhërrëfyesin për zbatimin e institutit ligjor të

- përshtatjes përkatëse, si dhe të planifikojë që të përfshijë mjete financiare për zbatimin e tij në aktivitetet e përditshme.
- Është e domosdoshme që IP në programet e tij vjetore për trajnime për deputetët e rinj dhe shërbimet të përfshijë çështjen e hendikepit përmes të cilës deputetët e rinj do të njiheshin me qasjen holistike të Konventës.
 - Programi i vendosur për edukim rekomandohet që të zgjerohet nga ana e IP dhe në të njëjtën të përfshihen trajnimet për Shërbimet e Kuvendit, në lidhje me sigurinë e qasshmërisë, komunikimit dhe trajnimeve për institutin ligjor të përshtatjes përkatëse.
 - Nevojitet që të ndërmerren masa për edukim, mentorim, dhe ngritje të kapacitetit dhe vetëbesimit të personave me hendikep, sidomos të rinjve me hendikep përmes vendosjes të programeve për punë praktike dhe vullnetarizëm në hapësirat e IP, për shembull "Një javë në IP"
 - Është e domosdoshme që IP të thellojë bashkëpunimin me personat me hendikep dhe OPH si partnerët e tyre në planifikimin dhe dizajnimin e aktiviteteve. Në atë drejtim mund të lidhet memorandum për bashkëpunim me organizatat të cilat kanë njohje gjithëpërfshirëse të detyrimeve të cilat rrjedhin nga Konventa
 - Me qëllim të rritjes të mundësive për qasshmëri, rekomandohet që IP të përgatis planin e veprimit për avancimin e qasshmërisë në fushëveprimin e tyre në punë si dhe të bëjnë analizë për të gjithë materialet e domosdoshme dhe pajisjet të cilat do u nevojiteshin për sigurimin e qasshmërisë funksionale në punën e tyre të mëtutjeshme.
 - Meqënëse çështja e pamundësisë sidomos sigurimi i qasshmërisë është e ndërlikuar, përfshin më shumë çështje dhe duhet të përditësohet vazhdimisht – edhe nga aspekti i standardeve dhe teknologjisë – kjo çështje kërkon përkushtim dhe vëmendje të madhe. Prandaj rekomandohet të paktën një i punësuar në kuadër të IP të punojë ekskluzivisht në qasshmërinë, ashtuqë ai apo ajo mund t'i përkushtojë të gjithë kohën e tyre dhe vëmendje në këtë temë, e madje edhe të specializohet dhe të zhvillohet në këtë fushë.
 - Duke patur parasysh nevojën e parashtrimit të analizave të ndryshme ligjvënëse në fusha të ndryshme, por edhe nevojën për zbatimin e detyrimeve nga Konventa, nevojitet edhe përforsimi i kapaciteteve të strukturës të PI, si dhe angazhimin e personave me njohje të domosdoshme në këtë fushë në radhët e tyre. Përmes kësaj do të mundësohet që analizat të cilat u parashtrohen deputetëve në fusha të ndryshme të përfshijnë edhe çështjen e pamundësisë.
 - Paralelisht nevojitet përfshirja e çështjes të hendikepit edhe në linjën buxhetore me çrast ata do ta inkorporonin dhe do ta merrnin parasysh dimensionin për çështjen e pamundësisë.
 - Me qëllim të promovimit më të madh dhe dukshmërisë të punës të IP rekomandohet organizimi i panairëve dhe vizitat e shkollave të rregullta dhe speciale, si dhe organizimin e vizitave speciale për nxënësit me hendikep, derisa IP nuk siguron pajisje të nevojshme që të sigurojë përshtatjen e përkatëse për personat me hendikep.
 - Përgatitja e materialeve të ndryshme të trajnimit dhe rekomandimit në formate të qasshme për punën e parlamentit, si punon parlamenti, çfarë punojnë deputetët dhe cili është roli i tyre si dhe informacione për mënyrat e parashtrimit të iniciativave nga ana e qytetarëve. Seancat e trajnimit mund të jenë të dizajnuara dhe të emitohet drejtëpërdrejtë dhe nxënësit me dhe pa hendikep do të kenë mundësinë për diskutim në lidhje përmbajtjen.
 - Përgatitja e dokumenteve kryesore në Parlament nga ana IP në formatet e qasshme, për shembull, Kushtetuta e shtetit në formatin audio dhe në gjuhën e shenjave, Rregullorja e Kuvendit në forma të qasshme dhe materiale tjera të cilat janë të rëndësishme për publikun.
 - Pas shembullit të Parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar, IP mund të përgatisë doracak për personat dhe institucionet të cilat në shtet kanë patur ndikim dhe kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në realizimin e të drejtave në bashkësinë me hendikep.



BIBLIOGRAFIA



- Strategjia Europiane për hendikep 2010–2020. E disponueshme në: <<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:0636:FIN:EN:PDF>>
- Plani i veprimit të Këshillit të Europës, viti 2006. E disponueshme në: <<http://www.coe.int/en/web/disability/action-plan-2006-2015>>.
- Byroja e PE-së, E disponueshme në: <https://www.europarl.europa.eu/about-parliament/en/organisation-and-rules/organisation/political-bodies>
- Gjuha britanike e shenjave : <https://www.parliament.uk/business/news/2020/february/pmqs-british-sign-language/>
- Komisioni i Venedikut, Deklarata e interpretuar e reviduar për Kodeksin e praktikave të mira për çështjet zgjedhore për pjesëmarrje të personave me hendikep në zgjedhje, 2011. E disponueshme në: <<http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD%282011%29045.aspx>>
- Zyra qeveritare për barazi, mars i vitit 2010, paragrafi 9, E disponueshme në: <<http://www.parliament.uk/documents/commons-committees/speakers-conference/7824.pdf>>
- Udhërrëfyeni për dëshmitarë të cilët japin dëshmi me shkrim apo me gojë deri te Dhoma e poshtme e Komitetit. E disponueshme në: <<https://www.parliament.uk/globalassets/documents/commons-committees/witnessguide.pdf>>
- Deklarata për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave me nevoja të veçanta, Gz zyrtare numër 50, 28 korrik i vitit 2003. E disponueshme në: <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/94E66D528301B3469BD4ED-2C440917ED.pdf>>
- Deklarata për pjesëmarrje politike e qytetarëve me aftësi të kufizuara, Gz. Zyrtare numër 267, 24 dhjetor i vitit 2019. E disponueshme në: <<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/032d-cec806e2435b90de68be6195e4de.pdf>>
- Deklarata, takimi i kryetarëve të grupeve politike të PE-së me Forumin Europian për hendikep, viti 2013. E disponueshme në: <https://www.socialistsanddemocrats.eu/sites/default/files/swo-=boda_disabilities_declaration_en_130606.pdf>
- Direktiva për qasshmëri të ueb-faqeve dhe aplikacionet mobile të organeve të sektorit publik. E disponueshme në: <<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32016L2102>>
- Raporti “Zbutja e rrugës për personat me hendikep ndaj politikës, 2015. Komisioni për barazi dhe të drejta të njeriut – Britania e Madhe, 2015. E disponueshme në: <<https://www.equalityhumanrights.com/en/file/4661/download?token=PII5W6zL>>
- Raporti i PETI; PE, E disponueshme në <https://www.eumonitor.eu/9353000/1/j9v-vik7m1c3gyxp/vh7ykb9uyqyu>
- Raporti i UN Enable, I disponueshëm në: <<http://www.un.org/esa/socdev/enable/faqs.htm>>.
- Raporti i Këshillit Europian i dorëzuar me kërkesë të PETI për zbatimin e KDPH nga ana e PE-së për vitin 2018. E disponueshme për: <[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/608830/IPOL_BRI\(2018\)608830_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2018/608830/IPOL_BRI(2018)608830_EN.pdf)>
- Raporti i OBSH, I disponueshëm në: <http://www.un.org/esa/socdev/enable/faqs.htm>].
- Raporti i FRA për të drejtat themelore të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, I disponueshëm në: <<https://fra.europa.eu/en/country/north-macedonia>>
- Ndërgrupi për çështjen me hendikep, I disponueshëm në: <http://www.edf-feph.org/disability-intergroup-european-parliament>
- Informatat për statusin e nënshkrim-it dhe ratifikimit të KDPH, shihni në: <<https://www.un.org/development/desa/disabilities/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html>>
- Komiteti për gra dhe barazi, Parlamenti i Britanisë të Madhe. I disponueshëm në: <https://committees.parliament.uk/committee/328/women-and-equalities-committee/>
- Konventa për të drejtat e personave me hendikep. E disponueshme në: <http://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>.
- Konventa për të drejtat e personave me hendikep, neni 4 dhe neni 33. E disponueshme në: <<http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Konvencija%20za%20pravata%20na%20licata%20so%20invalidnost.pdf>>
- Marta Nusbaum, Publikum “Aftësia dhe çështja e hendikepit”, Fordham Law Review 66

(1997): 273–300.

- GPNP 1976. E disponueshme në: <<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx>>

- Udhëzime për veprim të Komiteteve parlamentare pranë PE-së. Të disponueshme në: <http://edf-fep.org/toolkits-meps>

- Koment i përgjithshëm 16 (2005) për të drejtën e barabartë të burrave dhe grave për të gëzuar të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 3 nga ICESCR), të miratuar në seancën tridhjetë e katër të Komitetit, viti 2005, UN Doc. E/C.12/2005/4

- Koment i përgjithshëm nr. 2, 2014, Komiteti për të drejtat e personave me hendikep pranë OBSH

- Koment i përgjithshëm nr. 7, paragrafi 42, Komiteti i KDPH, 2018. I disponueshëm në <<https://www.ohchr.org/en/hrbodies/crpd/pages/gc.aspx>>.

- Instituti parlamentar, I disponueshëm në : < <https://www.sobranie.mk/aktivnosti-na-parlamentarniot-institut.nspix>>

- Grupi parlamentar për të gjithë partitë, I disponueshëm në: <https://www.disabilityrightsuk.org/policy-campaigns/all-party-parliamentary-disability-group-appdg>

- Rekomandimi CM/Rec (2011)14 i Komitetit të ministrave. E disponueshëm në: <https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cbe4e>.

- Rezoluta 2039(2015) për “Barazinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar”, KPKE 2015 (S5): <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-DocDetails-EN.asp?FileID=21339&lang=EN>.

- Rezoluta e Parlamentit Europain për gratë me hendikep, në dhjetor të vitit 2013, 2013/2065(INI). < <https://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-%2F%2FEP%2F%2FTEXT%2FTA%2BP7-TA-2013-0579%2B0%2BDOC%2BXML%2BV0%2F%2FEN&language=EN>>

- Rezoluta e Parlamentit Europain nga 2 shkurti i vitit 2017 për qasjen e integruar ndaj politikës sportive: qeverisja e mirë, qasshmëria dhe integriteti (2016/2143 (INI)). E disponueshme në: „ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2017-0012_

EN.html?redirect”

- Rezoluta e Parlamentit Europain, 23 nëntor 2016(2016/2952[RSP]).E disponueshme në:<http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P8-TA-2016-0442+0+DOC+XML+V0//EN>.

- Këshilli i Europës. Rekomandimi Rec (2006)5 i Komitetit të ministrave për Planin e veprimit 2006-2015. I disponueshëm në: <https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805af657>

- Strategjia për të drejtat e personave me hendikep 2017 – 2023, Këshilli i Europës, E disponueshme:<<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806fe7d4>>

- Të drejtat e njeriut dhe parlamentet, Doracaku për të punësuarit dhe anëtarët e parlamenteve, I disponueshëm në: < <<https://www.ibanet.org/Document/Default.aspx?DocumentUId=7B0B2D39-F3EC-4724-B797-C3CB68C51B57>>

- Kuvendi parlamentar pranë KE-së, Rezoluta 1823, 201, I disponueshëm në: <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=18011&lang=EN>

- Navanethem Pillay (2012). Strengthening the United Nations human rights treaty body system. A report by the United Nations High Commissioner for Human Rights, јuni 2012 г., ст. 85. E disponueshme në: <https://www2.ohchr.org/english/bodies/HRTD/docs/HCReportTBStrengthening.pdf>

- Materiale në formë video dhe të shtypur për qasshmërië e Parlamentit të Izraelit, Të disponueshme në: <https://main.knesset.gov.il/EN/About/Pages/Accessibility.aspx>

- Ligji për të drejtat e barabarta të qytetarëve me hendikep, Kapitulli D. Përfaqësimi përkatës i personave me hendikep. I disponueshëm në: <https://private.disabilityin.org/global/israel/>

- Komisioni për të drejtat e barabarta të personave me hendikep. I disponueshëm në: https://www.gov.il/en/departments/about/about_the_commission

- Udhërrëfyësi për dëshmitarë të cilët japin dëshmi me shkrim dhe me gojë deri te këshilli i Dhomës të poshtme të Komitetit. I disponueshëm në:< [54 |](https://www.parliament.uk/globalassets/documents/commons-committees/witness-</div><div data-bbox=)

guide.pdf>

- Videomateriali i Parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar për promovimin e aktiviteteve të parlamentit: "Të të inkurajojë ty që të inkurajojmë të tjerët", I disponueshëm në: <https://www.youtube.com/watch?v=zp6yt-8t2VsY>
- „Tregimi i juaj – historia jonë!” Parlamenti i Mbretërisë të Bashkuar, 2020, I disponueshëm në: < <https://learning.parliament.uk/en/resources/disability-illustrated-book/>>

